

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5668
E shtunë, 5 janar 2019
çmimi 0.40 €

Wielandi viziton UP-në, kërkon angazhim nga menaxhmenti i universitetit

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHGJET PACOLLI | FAQE 4-5

Dialogun Kosovë - Serbi nuk mund ta ndalë askush



Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se procesi i dialogut të Brukselit për Kosovën është i paalternativë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai

ka vlerësuar se këtë proces nuk mund ta ndalë askush. Sipas Pacollit, Kosova e dëshiron kontratën e paqes me fqinjën veriore, me të cilën Serbia obligohet ta njohë Kosovën shtet i pavarur dhe

soveran. Shefi i diplomacisë i ka ftuar partitë politike për unitet në dialogun Kosovë - Serbi, duke thënë se, nëse nuk do të ketë unitet të plotë, Kosova mund të çalojë në këtë proces

AKTUALE



**MAJLINDA BREGU,
SEKRETARE E
PËRGJITHSHME E
KËSHILLIT TË
BASHKËPUNIMIT RAJONAL**

F. 6

**FILLON NËNSHKRIMI
I PETICIONIT 'TA MBROJMË
ERENIKUN'**

F. 10

**VETËVENDOSJA DYSHON SE
KA PASUR KEQPËRDORIME
NË TENDERIN E QUMËSHIT
PËR FËMIJËT**

F. 10

Sfidat e Speciales



Përveç procesit të dialogut, Republika e Kosovës gjatë këtij viti pritet të përballë edhe me Gjykatën Speciale. Ky ballafaqim është vlerësuar tejet sfidues për institucionet e Kosovës nga drejtuesit e shtetit dhe avokatët. Megjithatë, kryeparlamentari Veseli

dhe kryeministri Haradinaj kanë thënë se Kosova dhe lufta e UÇK-së do të dalë më e fuqishme nga kjo sfidë. Ndërsa avokati Tomë Gashi ka bërë thirrje për rritjen e fondit për mbrojtjen e të akuzuarve në mënyrë që të ofrohet mbrojtje sa më efektive juridike

FAQE 3

Shkolla që po shkatërrohet në heshtje

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

EKONOMI



**VITI 2019, VIT I NJË KRIZE TË
RE EKONOMIKE?**

F. 9

**ÇDO VIT PENSIONOHEN RRETH
60 TË PUNËSUAR NË
NDËRMARRJEN 'TREPÇA'**

F. 9

KULTURË

DRAMË QË TË PREKË THELLË

F. 6

Ekrem KRYEZIU

SPORT

**DEMAKU: ËNDËRROJ
TË LUAJ PËR KOSOVËN OSE
SHQIPËRINË**

F. 18



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Zaevi kërkon votat e opozitës shqiptare për ndryshimet kushtetuese

Kryeministri Zoran Zaev, ka paralajmëruar se deri në ditën e nisjes së debatit për miratim në Kuvend, do të zhvillojë takime me partitë opozitare shqiptare për t'i bindur për rëndësinë që ka miratimi i ndryshimeve, që zgjidh kontestin e emrit me Greqinë dhe i hap rrugën integritit euroatlantik



SHKUP, 4 JANAR - Partitë politike shqiptare kanë qëndrime të ndryshme lidhur me përfitimet e mundshme nga ndryshimet kushtetuese për zbatimin e marrëveshjes së emrit me Greqinë.

Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, thotë se me miratimin e ndryshimeve kushtetuese javën që vjen dhe me zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë, realizohet synimi kryesor i shqiptarëve, anëtarësimi i vendit në NATO, që sipas tij, garanton paqe, siguri dhe zhvillim ekonomik. Me këtë, pra nisjen e bisedimeve me BE-në dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, që avancojnë statusin zyrtar të gjuhës shqipe, sipas Osmanit, arrihen kërkesat kryesore të shqiptarëve në Maqedoni.

"Nuk ka proces më të rëndësishëm për momentin për shqiptarët, por edhe për gjithë qytetarët e Maqedonisë sesa përfundimi i ndryshimeve kushtetuese që do të hapë rrugë për në NATO dhe BE. Anëtarësimi në NATO garanton paqen, stabilitetin, zhvillimin ekonomik, garanton të ardhmen dhe në jemi të

kënaqur me këtë proces, rumbullakohet një ëndërr e gjeneratave dhe e përkushtimit tonë për anëtarësim në Aleancën Veri-atlantike", deklaron Osmani.

Por, për Aleancën për Shqiptarët edhe ndryshimet kushtetuese që tashmë ndodhen në fazën e fundit për miratim, javën e ardhshme nuk do të sjellin ndonjë ndryshim sa i përket pozitën kushtetuese të shqiptarëve për barabarësi.

"Edhe në këto ndryshime kushtetuese nuk ka asgjë për shqiptarët. Disa modifikime kozmetike që tenton t'i bëjë kryeministri Zoran Zaev, nuk ka asgjë qenësore. Sërish tentohet që me çdo kusht edhe me ndryshimet e reja kushtetuese që të theksohet se Maqedonia është shtet i kombit maqedonas dhe i përbërësve të tjerë etnik", thotë Elmi Aziri, nga Aleanca për Shqiptarët, e cila së bashku me Lëvizjen Besa kanë paraqitur disa amendamente për avancimin e pozitën së shqiptarëve në Maqedoni, si bërjen e shqiptarëve popull shtetformues dhe definimin e shqipes si gjuhë zyrtare, e jo si gjuhë që e flasin 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës.

Aziri thotë se viti 2018 ishte zhgënjyes për shqiptarët, meqë ata, sipas nënkryetarit të kësaj partie opozitare, nuk arritën asnjë nga synimet, por edhe premtimet që ishin dhënë nga kryeministri Zoran Zaev, ndërsa ndalet në Ligjin për gjuhën shqipe, që ende nuk ka marrë epilog konkret.

"Arritëm me marrëveshjen e koalicionit që të miratojmë një Ligj për gjuhën shqipe, megjithatë ende ai ligj nuk është firmosur nga kryetari i shtetit dhe ende nuk është në fuqi. Kjo paraqet një zhgënjim të madh për shqiptarët dhe një vazhdimësi të një logjike të vjetër të politikëbërjes dhe të etnisë shqiptare në Maqedoni",

thekson Aziri.

Ai vë theksin edhe te buxheti i shtetit për vitin 2019, i cili sipas tij, nuk dallon nga buxhetet e viteve të kaluar në aspekt të ndarjes së mjeteve. Më shumë para, sipas tij, vazhdojnë të destinohen në zonat e banuara me popullatë maqedonase në pjesën lindore të vendit, duke anashkaluar kështu rajonet rurale të banuara me popullatë shqiptare.

Edhe nga Forumi i Intelektualëve Shqiptarë shprehen me doza pakënaqësie ndaj asaj që kanë arritur shqiptarët, të cilët siç theksojnë, kanë dhënë shumë për konsolidimin e këtij shtetit që ndodhej pranë një destabilizimi të madh lidhur me aferën e

përgjimeve, protestat, proceset gjyqësore e ngjarjet e 27 prillit.

"Mendoj se viti 2018 nuk ka qenë i suksesshëm për shqiptarë dhe unë mendoj se nga të gjitha këto eksploatime të forcës së shqiptarëve, ata do të nxjerrin një përvojë të cilën do të shfrytëzojnë në vitin 2019", ka deklaruar Shpëtim Pollozhani, nga Forumi i Intelektualëve Shqiptarë.

Kryeministrit Zoran Zaev, ndërkohë, ka paralajmëruar se deri në ditën e nisjes së debatit për miratim në Kuvend, do të zhvillojë takime me këto parti për t'i bindur për rëndësinë që ka miratimi i ndryshimeve, që zgjidh kontestin e emrit me Greqinë dhe i hap rrugën integritit euroatlantik.

Senati s'pranon kandidaturën e Trumpit për ambasadore në Shqipëri

WASHINGTON, 4 JANAR - Sipas ndihmësve në komisionin e Senatit amerikan për çështjet e jashtme, kandidatura e Kathleen Ann Kavalec, e emëruar si ambasadore e ShBA-së në Tiranë, i është kthyer të enjten presidentit Donald Trump. Kavalec u emërua nga presidenti Trump në korrik 2018 dhe qysh nga ajo kohë, kandidatura e saj ka qenë në pritje për t'u konfirmuar nga komisioni i Senatit. Kavalec ishte parashikuar të dilte në një seancë në Ssenat në muajin shtator, si pjesë e procesit të konfirmimit, por përfundimisht nuk dëshmoi dhe emri ishte hequr nga njoftimi për seancën. Një javë para seancës emri i saj

ishite përmendur në një artikull të gazetës Washington Examiner që kishte të bënte me komunikimet e një zyrtari të Departamentit të Drejtësisë me ish-agjentin britanik Christoph Steele. Steele u dorëzoi agjencive amerikane të zbulimit një raport për lidhje të mundshme të fushatës Trump me rusët.

Emri i Kavalec ende figuron në faqen e Shtëpisë së Bardhë si e emëruar për postin. Sipas rregullave të Senatit, kur koha e pritjes për konfirmim i kalon të 30 ditët, kandidatura i kthehet presidentit, por komisioni i Senatit mund ta anashkalojë këtë rregull me një votë konsensuale.



Sfidat e Speciales



Përveç procesit të dialogut, Republika e Kosovës gjatë këtij viti pritet të përballet edhe me Gjykatën Speciale. Ky ballafaqim është vlerësuar tejet sfidues për institucionet e Kosovës nga drejtuesit e shtetit dhe avokatët. Megjithatë, kryeparlamentari Veseli dhe kryeministri Haradinaj kanë thënë se Kosova dhe lufta e UÇK-së do të dalë më e fuqishme nga kjo sfidë. Ndërsa avokati Tomë Gashi ka bërë thirrje për rritjen e fondit për mbrojtjen e të akuzuarve në mënyrë që të ofrohet mbrojtje sa më efektive juridike

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 4 JANAR - Krahas problemeve të brendshme dhe atyre në arenën ndërkombëtare, shteti i Kosovës këtë vit do të ketë fokus të veçantë edhe në ballafaqimin me Gjykatën Speciale e cila deri më tani ka ftuar për intervistim disa ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Gjykata Speciale do të jetë një sfidë nga e cila Kosova do të dalë edhe më e fuqishme. Ai i ka ftuar bashkëlufetarët që t'u përgjigjen thirrjeve të Dhomave të Specializuara sepse, sipas Veselit, sado e padrejtë të jetë kjo gjykatë,

primar duhet të jetë interesi kombëtar i shtetit tonë. "Gjykata Speciale do të jetë një sfidë nga e cila Kosova do të dalë edhe më e fuqishme. Nga kjo sfidë edhe më e fuqishme do të dalë lufta e drejtë dhe e shenjtë e UÇK-së. Sfidat janë procese që nuk e ndalin Kosovën. Ne do ta vazhdojmë rrugëtimin tonë, do t'i përgjigjemi kësaj sfide. Ftoj të gjithë bashkëlufetarët t'u përgjigjen thirrjeve të Dhomave të Specializuara. Sado e padrejtë kjo Gjykatë, sado sfiduese, ne duhet ta kemi çdoherë primar interesin kombëtar të shtetit tonë", ka deklaruar Veseli për gazetën "Epoka e re". Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar

se ky vit nuk do të jetë i lehtë për Kosovën për shkak të sfidës së dialogut me Serbinë dhe Gjykatës Speciale, por ai ka bërë me dije se do t'i përkrahë të gjitha ata që do të përballen me këtë gjykatë. Sipas Haradinajt, nuk duhet të ndodhë që ndonjë ish-pjesëtar i UÇK-së të bëjë ndonjë veprim të pahijshëm dhe të pandershëm për Kosovën. "Si Aleancë besoj se kurrë punët më mirë për zgjedhje nuk i kemi pasur, por nuk e di sa është në interes të vendit shkruarja në zgjedhje të reja në proceset që është Kosova. Asnjëherë nuk do t'i kërkoj zgjedhjet për interes të Aleancës. Ne jemi të gatshëm për këtë proces nëse dikush e vlerëson atë si hap të duhur. Do të ishte më mirë që këtë vit ta shfrytëzojmë për përfundimin e disa punëve që kanë mbetur pa u kryer. Do të ishte mirë që ta përmbylim sovranitetin tonë të brendshëm dhe ta mbyllim marrëveshjen me Serbinë e cila ka mbetur hapur dhe e cila do ta sillte njohjen nga Serbia dhe ulësen në OKB. Viti 2019 do të jetë një vit i rëndësishëm, sepse do të jenë edhe implikimet e Gjykatës Speciale. Mirëpo qëllimi im është ta ruajmë Kosovën. Nuk do të kërkoj zgjedhje. Do ta kërkoj vetëm konsolidimin e Kosovës. Po ashtu, jam i interesuar t'i ruaj

ish-pjesëtarët e UÇK-së, pra t'i përkrah të gjitha ata që përballen me këtë sfidë. Ne duhet ta nderojmë veten edhe para drejtësisë, duke mos u turpëruar. Nuk duhet të ndodhë që ndonjë ish-pjesëtar i UÇK-së të bëjë ndonjë veprim të pahijshëm dhe të pandershëm për Kosovën", ka deklaruar Haradinaj për gazetën "Epoka e re".

Tomë Gashi: Kosova ta rritë fondin për mbrojtjen e të akuzuarve nga Specialja

Edhe avokati Tomë Gashi ka thënë të premtën se do të jetë sfiduese për Kosovën ballafaqimi me Gjykatën Speciale. Ai ka theksuar se e vetmja e mirë që tani mund të bëjë shteti i Kosovës është që ta rrisë fondin për mbrojtjen e atyre që do të akuzohen nga Gjykata Speciale. Sipas tij, është tepër e vogël për të mos thënë qesharake shumica prej një milion e 500 mijë eurosh që është ndarë për të akuzuarit, avokatët, familjet e të akuzuarve dhe për dëshmitarët. "Kosovës si shtet i pavarur askush nuk ia ndalon që ta rrisë fondin për mbrojtjen e të akuzuarve në Gjykatën Speciale që të mund të formohen ekipet

më të mira të avokatëve në mënyrë që të ofrohet mbrojtja sa më efektive juridike që mundësisht asnjë prej ish-pjesëtarëve të UÇK-së të mos gjendet fajtor për veprat morbide të cilat i përmend raporti i senatorit Dick Marty", ka thënë Gashi për gazetën "Epoka e re".

Avokati ka thënë se Gjykata Speciale, përkatësisht Zyra e Prokurorit Special, ka filluar punën dhe tashmë disa të dyshuar janë ftuar të japin deklarata, e disa prej tyre veçse i kanë dhënë deklaratat në dhjetor të vitit 2018. Gashi ka paralajmëruar se akuzat e para do të ngrehën në pjesën e parë të këtij viti por, sipas tij, askush nuk e di se kush do të akuzohet. "Ky është vetëm fillimi dhe askush nuk duhet të mendojë që Gjykata Speciale do të merret me 7 apo 8 persona që i ka ftuar deri më tani. Ende nuk kemi raste të gjykimit, nuk kemi as raste të akuzave, por këto me siguri se do të ndodhin gjatë këtij viti. Akuzat e para me siguri se do të ngrehën në pjesën e parë të këtij viti, por askush nuk e di se kush do të akuzohet. Aktualisht kemi vetëm persona të dyshuar", është shprehur Gashi, duke shtuar se Gjykata Speciale do të merret me periudhën prej 18 muajve gjatë luftës dhe 18 muajve pas luftës.

Mosliberalizimi i vizave detyron Labinot Tahiri ta dorëzojë pasaportën me dy viza

PRISHTINË, 4 JANAR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Labinot Tahiri, ka dorëzuar të premtën pasaportat e tij, pasi nuk është bërë liberalizimi i vizave në vitin 2018. "Veprimi im si deputet dhe qytetar, duke dorëzuar në organet përkatëse pasaportat e

mia me viza të Amerikës dhe të Gjermanisë", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook", ku ka postuar edhe një video duke hyrë në objektin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky ishte edhe premtimi i tij si

deputet tash e një kohe se, "nëse nuk bëhet liberalizimi i vizave brenda vitit 2018, ai do t'u bashkohet gjithë qytetarëve të tjerë të Kosovës duke dorëzuar pasaportat e tij". "I falënderoj nga zemra ambasadat që më kanë pajisur me viza, por tani

unë më nuk do të udhëtoj jashtë Kosovës për shkak të dëshpërimit që kam si deputet, pasi qytetarët tanë nuk e gëzuan liberalizimin e vizave. Evropa duhet të bëjë më shumë për qytetarët e Kosovës", ka shkruar deputeti Tahiri.



Flet për "Epokën e re", Behgjet Pacolli

Dialogun Kosovë - Serbi n



Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se procesi i dialogut të Brukselit për Kosovën është i paalternativë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se këtë proces nuk mund ta ndalë askush. Sipas Pacollit, Kosova e dëshiron kontratën e paqes me fqinjën veriore, me të cilën Serbia obligohet ta njohë Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Shefi i diplomacisë i ka ftuar partitë politike për unitet në dialogun Kosovë - Serbi, duke thënë se, nëse nuk do të ketë unitet të plotë, Kosova mund të çalojë në këtë proces

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 JANAR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se procesin e dialogut me Serbinë nuk mund ta ndalë askush. Ai ka thënë se Republika e Kosovës nuk ka alternativë tjetër pos dialogut dhe marrëveshjes historike me Serbinë. Në pjesën e dytë të intervistës dhënë gazetës "Epoka e re" për numrin festiv, kryediplomati Pacolli ka vlerësuar se Kosova e dëshiron kontratën e paqes me fqinjën veriore, me të cilën Serbia obligohet ta njohë

Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. "Republika e Kosovës e dëshiron dialogun dhe dëshiron kontratën e madhe të paqes. Me këtë kontratë, Serbia obligohet ta njohë Republikën e Kosovës menjëherë dhe mos ta pengojë më Kosovën në integrimet e saj euroatlantike. Besoj shumë se ky dialog do të ndodhë dhe askush nuk mund ta ndalë këtë proces, sepse dialogu është një evolucion i kohës moderne", ka thënë Pacolli.

Ai ka deklaruar se edhe letra e presidentit amerikan Donald Trump e obligon Kosovën për dialog me Serbinë. Pacolli ka thënë se presidenti amerikan pret që marrëveshja finale të fes-

tohet në Shtëpinë e Bardhë. "Letra e presidentit Trump tregon qartë se duhet të ndodhë marrëveshja historike dhe paqja në mes këtyre dy shteteve. Nëse studiohet kjo letër, nuk lihet asnjë alternativë tjetër, pos uljes në tavolinë dhe trajtimit në mënyrë serioze të kësaj çështje, deri në arritjen e marrëveshjes historike. Presidenti amerikan pret që në Shtëpinë e Bardhë të festohet për këtë marrëveshje", është shprehur Pacolli.

Ministri Pacolli ka ftuar edhe dy partitë e mëdha opozitare që t'i bashkohen ekipit negociator të Kosovës në dialog. Sipas tij, Kosovës në këtë proces i duhet unitet politik dhe jo përçarje.

Nuk mund ta ndalë askush

me Kosovën duke pranuar faktin se në këtë rajon ka lindur një shtet para dhjetë vjetëve, i cili tashmë ka kushtetutën e vet, kufijtë dhe institucionet e veta. Ky shtet është demokratik dhe komuniteti serb gëzon të drejtat më kualitative që mund t'i gëzojë një pakicë tjetër kombëtare diku në botë. Serbia, po ashtu, duhet ta kuptojë se, nëse dëshiron të bashkëpunojë me Kosovën dhe të përfitojë nga tregu i saj, duhet ta respektojë faktin që e përmenda më lart dhe të fillojë të dialogojë me të njëjtin nivel me Kosovën. Republika e Kosovës e dëshiron dialogun dhe dëshiron kontratën e madhe të paqes. Me këtë kontratë, Serbia obligohet ta njohë Republikën e Kosovës menjëherë dhe mos ta pengojë

më Kosovën në integrimet e saj euroatlantike. Besoj shumë se ky dialog do të ndodhë dhe askush nuk mund ta ndalë këtë proces, sepse dialogu është një evolucion i kohës moderne. Po e shohim çdo ditë se ky evolucion po mbështet nga faktori ndërkombëtar.

"Epoka e re": Përmes një letre drejtuar presidentit Hashim Thaçi, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka kërkuar që Kosova të flasë me një zë rreth dialogut. Si duhet t'i përgjigjet spektri politik kësaj letre?

Pacolli: Letra e presidentit Trump tregon qartë se duhet të ndodhë marrëveshja historike dhe paqja në mes të këtyre dy shteteve. Nëse studiohet kjo letër, nuk lihet asnjë alternativë

tjetër, pos uljes në tavolinë dhe trajtimit në mënyrë serioze të kësaj çështje, deri në arritjen e marrëveshjes historike. Presidenti amerikan pret që në Shtëpinë e Bardhë të festohet për këtë marrëveshje.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kësaj letre, opozita po e kundërshton këtë proces. Sipas saj, kompromisi për vendin do të jetë i dhimbshëm. Cili është koment juaj?

Pacolli: Është mendim i tyre. Unë jam ministër i Punëve të Jashtme dhe qëndrimet e mia rreth këtij procesi janë ato që përfshijnë mendimin e unifikuar të spektrit politik në Kosovë. Në momentin që ka tema, unë do të flas për këto tema, dhe në momentin që ka një deklaratë e

cila mbështetet nga faktori politik në Kosovë, atëherë unë do të flas për atë deklaratë. Tani për tani, nuk dua të flas as për vendimet e presidentit e as për atë të ekipit shtetëror të dialogut.

"Epoka e re": Çfarë nëse nuk do të ketë unitet të plotë Kosova në këtë proces?

Pacolli: Unë kërkoj vetëm unitet politik. Nëse nuk ka unitet politik ne do të çalojmë në këtë proces. Sot ekipi negociator për dialog duhet të punojë në harmoni me presidentin e vendit. Presidenti deri sot ka qenë autori i dialogut dhe unë jam i bindur se presidenti ka vullnet të bisedoj dhe të bashkëpunojë me delegacionin shtetëror të dialogut.

Wielandi viziton UP-në, kërkon angazhim nga menaxhmenti i këtij universiteti

PRISHTINË, 4 JANAR (ER) - Zëvendës-presidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, ka vizituar të premten Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ku është pritur në takim nga rektori i këtij universiteti, prof. dr. Marjan Dema. Dema u shpreh i lumtur për vizitën që Wielandi ia ka bërë Universitetit të Prishtinës. Ai i ka informuar vizitorët për rëndësinë dhe progresin që ka shënuar UP-ja, duke theksuar se Universiteti i Prishtinës dhe rrugëtimi i tij janë storie suk-

sesi. "Ne kemi bërë progres në disa fusha por, mbi të gjitha, kemi krijuar standarde të aplikueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë", ka thënë Dema në këtë takim, duke potencuar faktin që UP-ja është në proces të transformimit të tij.

Në anën tjetër, zëvendës-presidenti Wieland e ka falënderuar rektorin Dema për pritjen, duke pohuar se është shumë i lumtur, për faktin që krijimi i standardeve zuri vend në fjalën prezantuese të rektorit Dema. "Prodhoni studentë

për t'u punësuar, prodhoni studentë të gatshëm për jetë si dhe të vullnetshëm për të kontribuar dhe prosperuar", ishte porosia e Wielandit për menaxhmentin e universitetit. Zëvendës-presidenti Wieland e ka vizituar Fakultetin Juridik, ku ka ligjëruar para studentëve të UP-së me temën "Bashkimi Evropian - dje, sot, nesër". Ligjërata u pasua me diskutim të hapur me studentët për çështje me interes për vendin.

Wieland, përveç funksionit si zëvendës-president në

Parlamentin Evropian, ka përvojë të gjerë në fushën e ligjit, teksa është edhe anëtar i Komitetit të Peticioneve. Rektori i UP-së, Marjan Dema, në këtë takim ishte i shoqëruar nga prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar, prof. ass. dr. Dashmir Bërxulli, prorektorja për zhvillim dhe cilësi, prof. asoc. dr. Merita Kocinaj-Berisha, dekani i Fakultetit Juridik, prof. dr. Haxhi Gashi, sekretari i UP-së, Esat Kelmendi, si dhe këshilltari juridik, prof. Flamur Hyseni.



Pacolli ka bërë me dije se nëse nuk do të ketë unitet politik në këtë proces Kosova do të çalojë.

"Epoka e re": Z. Pacolli, këtë vit Kosova do ta fillojë procesin e fazës finale të dialogut me Serbinë. Sa sfidues do të jetë ky proces për shtetin e Kosovës dhe politikën e jashtme?

Pacolli: Ndoshta kam pasur të drejtë që çdoherë kam thënë se dialogu është e vetmja alternativë e Kosovës. Kam qenë çdo herë ithtar i madh i dialogut. Prej se jam në skenën politike, gjithmonë kam thënë se opsioni i luftës ka marrë fund dhe kurrë më këtu nuk do të ketë luftë. Serbia duhet të ulet në tavolinë

Dramë që të prekë thellë

Ekrem KRYEZIU

Pas suksesit të Festivalit të Dytë Ndërkombëtar Teatror në dhjetor të vitit 2018, i cili u organizua në Teatrin "Faruk Begolli" të Kolegjit AAB, garuan trupa teatrore nga Kosova, Italia, Bullgaria, Kroacia dhe Shqipëria (me dy drama). Ndërkaq, në vigjilje të vitit të ri 2019, më 26 dhjetor 2018, në orën 20:00, u inaugurua skena kamertale e Teatrit "Faruk Begolli". Me inaugurimin e kësaj sale u hap edhe një dritare, që frymëmarrjes teatrore t'i shtohet fuqia. Me këtë hap Kolegji AAB po bëhet jo vetëm qerthull i dijes, po edhe institucioni më i kompletuar teatror në Kosovë.

Trupa "Ad hok" e AAB-së në këtë sallë shfaqti dramën "Bretkosa" të autorit nga Bosnja e Hercegovina, Dubravko Mihanović, e adaptuar për shikuesit e Kosovës nga Sadet Beqiri. Tema e kësaj veprë, për kah ideja, ngjason me të gjitha dramat e letërsisë së vendeve që kanë përjetuar

luftëra.

Karakteristikë kryesore e kësaj veprë, që me nder e radhit krahas veprave të proveniencës së letërsisë botërore "War and after war" (Lufta dhe pas lufta), njerëzorja është në plan të parë. Edhe pas mbarimit të luftërave plagomat që lënë luftërat në njeriun vështirë shërohen.


Drama "Bretkosa", e ndërtuar dhe e adaptuar mbi këto koordinata stilistike, bëri që publiku shqiptar në këtë sallë kamertale të Kolegjit AAB ta përjetojë thellë fatin e personazheve ngaqë kjo temë sa ishte botërore ishte edhe plagomë e popullit shqiptar të Kosovës.

"Kuarteti" i aktorëve, i prirë nga Ilir Tafa, "berberi", kryepersonazhi i kësaj drame, rolin e të cilit Ilir Tafa gjatë shfaqjes e ndërtoi me ritme dhe kundërritme, sa fizike aq edhe njësorë. Variacionet e interpretimit të tij shqueshin edhe me të folurit sa me turp, sa me plasje të herëpashershme që shënjonin baticat dhe zbaticat e oqeanit të dhembjes, buburitë në shpirtin e "Berberit" ish-luftë-

tar, të cilit i ishin vrarë shokët e togut e ai e mallkonte veten që ka shpëtuar. Plasjet e tij hove hov ngjasonin me erupsione "vullkanike" që nuk e linin të qetë shpirtin e tij.

Interpretimin "filigran" të Ilir Tafës denjësisht e përcollën Donat Qosja, Basri Shala dhe Valmir Krasniqi. Secili veç e veç dhe të gjithë së bashku, të mbikëqyrur nga regjisorja Burbuqe Berisha dhe asistenti i saj Ledri Vula, dëshmonin në mënyrën më njerëzore për pasojat që lufta dhe paslufta kishte lënë vragë të mëdha në personazhet që ata luanin.

Kjo shfaqje jo vetëm se e meriton, por e ka për obligim kulturor të nisë një pelegrinazh teatror nëpër çdo qytet të Kosovës, patën apo s'patën sallë teatri, ngaqë shfaqja e mrekullueshme është e "paketuuar" ashtu që të komunikojë me sukses kudo që të shfaqet dhe nga akëcila "skenë" të ngrihet komunikon me sukses me shpirtin e molisur të atyre që plagomat e luftës ende lëngojnë në ta, e të atillë ka anekënd Kosovës.



Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 JANAR - Majlinda Bregu ka marrë të premtën detyrën e sekretares së përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR) pas emërimit të saj nga Ministri i Jashtëm të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) në Brdo pri Kranju, Slloveni, më 23 prill 2018. Bregu është një politikane shqiptare me përvojë të gjatë dhe me besim të palëkundur në projektin e Bashkimit Evropian.

Majlinda Bregu zëvendëson në këtë post Goran Svilanović, i cili e mbajti këtë detyrë për dy mandate të njëpasnjëshme (2013-2018). "Përtej dallimeve dhe kufijve gjeografikë kemi një interes të përbashkët. Jean Monnet ishte i bindur se 'kombet evropiane duhet të bashkohen për të mbijetuar'. E njëjta gjë vlen edhe për Ballkanin Perëndimor. Për ta ruajtur peshën në një botë që po ndryshon shpejt, duhet t'i forcojmë marrëdhëniet tona. Bashkëpunimi, është kryefjala! Jam e nderuar ta marr detyrën e Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Në një zonë ku për vite të gjata sfida ka qenë mbajtja gjallë e konfliktit. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal ka ndihmuar për fuqizimin e një realiteti të ri: atë të angazhimit të përbashkët për të ardhmen evropiane të rajonit. Mbështetja për

reformat në Evropën Juglindore ka qenë dhe do të vijojë të jetë bërthama e përpjekjeve të KBR-së. Jam e bindur se së bashku, nën drejtimin politik të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe mbështetjen e Bashkimit Evropian, duke përfshirë median, shoqërinë civile, së bashku do të përpiqemi të bëjmë zgjedhje të mençura, që nxisin e mbështesin dialogun me të gjitha grupet në shoqëri. Nuk do të jetë e lehtë, e di. Do të jetë një sfidë 'të notosh' në mes të situatave të vështira ekonomike, shoqërore dhe politike", ka thënë Bregu.

Ajo ka shtuar se është fakt që e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është e lidhur ngushtësisht me zhvillimin e përbashkët. "Ndërlidhja! Integrimi i ekonomive tona në një treg të vetëm, lidhja e njerëzve dhe bashkëjetesa e vlerave; investimi në kapitalin njerëzor dhe intelektual. Çdo reformë lidhet me interesin tonë të përbashkët politik, atë të sigurisë dhe dukshëm me atë ekonomik. Nuk është e rastësishme që nevoja për Evropë në rajon është kaq e fuqishme. E bindur se ritmi i zhvillimit rajonal do të ndikojë në ritmin e integritit tonë evropian, për mua është një privilegj shumë i madh që do të drejtoj KBR-në (RCC) po aq sa është një sfidë të cilën bashkë me stafin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, shpresoj ta përballoj faqebardhë", ka deklaruar Majlinda Bregu.



Kërkohet bashkëpunim për arsimin parauniversitar në kryeqytet

PRISHTINË, 4 JANAR (ER) - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi gjendjen e reformave që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, në veçanti zbatimin në praktikë të kurrikulës së re, ka identifikuar se në këtë segment ka nevojë për mbështetje profesionale dhe në mënyrë permanente nga institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal.

DKA-ja për t'iu përgjigjur këtyre zhvillimeve reformuese që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimension, në mënyrë që proceset e filluara të gjejnë zbatueshmëri të duhur në institucionet tona. Në funksion të këtyre zhvillimeve DKA-ja, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, kanë hartuar planin e bashkëpunimit në

mes të shkollave-mësimdhënësve për vitin shkollor 2018-2019, duke inkorporuar tema esenciale të cilat janë determinuese për mbështetjen e proceseve reformuese, që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar. "Prandaj më 4 janar 2019, në funksion të këtyre proceseve arsimore, u zhvilluan takimet bashkëpunuese në tri qendrat e caktuara, si në: ShFMU 'Dardania', ShFMU 'Hilmi Rakovica' dhe ShFMU 'Faik Konica', ku në këto takime morën pjesë mësimdhënësit e 19 shkollave fillore të komunës sonë në mënyrë që takimet e bashkëpunimit të rrjedhin sipas standardeve dhe kërkesave të parapara. Në secilën fushë të kurrikulës janë caktuar trajnerë kompetentë dhe profesionalë për mbështetje të mësimdhënësve me këshilla profesionale", është thënë në njoftimin për media të Komunës së Prishtinës.



Po ashtu, mësimdhënësit në këto qendra të takimit u vizituan edhe nga drejtori i Arsimit, Jonuz Salihaj, dhe koordinatori i kurrikulës në nivel komune, Fatos Osmani, për t'iu inkurajuar dhe mbështetur mësimdhënësit në këtë proces. "Pra, me këtë plan dinamik rol kyç

do të jetë forcimi dhe bashkëpunimi në mes shkollave, mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale (seksioneve) të shkollave, duke u mobilizuar për procese progresive, sepse mësimdhënësit janë promotorë të këtyre zhvillimeve reformuese. Andaj,

bashkëpunimi në mes të shkollave, aktiveve apo fushave të kurrikulës do të jenë të koordinuara mirë, në mënyrë që proceseve reformuese t'u përgjigjemi bashkërisht dhe në mënyrë profesionale", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Shkolla që po shkatërrohet në heshtje

EPOKA
ERE

Ismail REXHEPI

LIPJAN, 4 JANAR - Shkolla Fillore "Emin Duraku" në Banullë - Gllgovc të Komunës së Lipjanit ishte e dalluar në nivel vendi. Kjo shkollë ka një historik të gjatë të punës edukative-arsimore, për të cilën edhe sot gjenerata të shumta flasin fjalë të mëdha për punën që është bërë këtu nga mësimdhënës të dalluar.

Nga kjo vatër arsimore, ku mësimet i vijonin nxënësit e disa fshatrave, si: Banulla, Gllgovci, Gumnasella, Llugaxhia, Qallapeku, Rubovci e Kojksa, dolën kuadro të njohura në fushën e mjekësisë, inxhinierë të makinerisë dhe të elektrikes, teknologë, mësimdhënës e profesorë, inxhinierë të ndërtimitarisë etj. Po ashtu, nga nxënësit e saj kishte edhe veprimtarë të çështjes kombëtare të cilët pushteti serbosllav i dënoi me disa vjet burgim.

Kjo vatër e arsimit fillor ka një sipërfaqe të madhe të oborrit. Një pjesë e madhe e tij ishte me pisha, plepa dhe pemë. Kishte edhe terrenet sportive dhe ato të gjimnastikës. Kabinetet ishin më modernet në vend, bibliotekë me një fond të madh të librave, kopshtin para shkollës përplot me lule të rregulluara për mrekulli, pastaj fontanën, basenin që nuk e kishte asnjë shkollë tjetër. Kur kujtohet e kaluara e saj, e si është ajo sot është tmerr. Pra, pasi ajo mbeti pa nxënës, për

një kohë të shkurtër nga dora shkatërrimtare u bë si ta kishte goditur ndonjë tërmet shumë i fuqishëm. Sot i ka vetëm muret, e tëra e shkatërruar, si shkolla edhe objektet përcjellëse.

Shkolla ka vite që mbeti pa nxënës, sepse ata filluan të mësojnë në objektet e reja në fshatrat e tyre, si në Banullë, Gllgovc e Bujari. Për fat të keq, askush as sot nuk e di pse mbeti e harruar kjo shkollë.

Adil Avdullahu, ish-drejtor i kësaj shkolle prej vitit 1990-1996, si dhe një kohë të gjatë edhe arsimtar, gjatë bisedës me të ka shpalosur një historik të Shkollës Fillore "Emin Duraku" në Banullë-Gllgovc të Komunës së Lipjanit, duke përmendur mësimdhënës të parë dhe drejtorë. Pra, sipas tij, kjo vatër arsimore gjithmonë ka pasur mësimdhënës të zgjuar dhe nxënës të aftë. "Ajo ishte e kompletuar edhe me kabinete arsimore, madje kabinetin e fizikës e shfrytëzonin edhe studentët e Universitetit të Prishtinës. Prandaj, kjo shkollë nuk e meriton të jetë në këtë gjendje në të cilën është sot", tha Adil Avdullahu, ish-drejtor i saj.

Më tej, ai pohoi se kjo shkollë duhet sa më parë të rinovohet dhe të funksionojë në shkollë të mesme ku ka numër të madh të nxënësve të fshatrave përreth. "Pra, kjo do të ishte lehtësi për nxënës, sepse nuk do ta paguanin rrugën që e paguajnë për të shkuar në Lipjan. Këtu nxënësit vijnë në këmbë, se e



kanë shumë afër. Në këtë rast kursehen nxënësit, mësimdhënësit e stafi teknik. Mirëpo, do të kishte qenë veprim i qëlluar të hapej ndonjë fakultet kur dihet se shkolla është e rrethuar nga rrugët, ku afër e ka edhe magjistralen Prishtinë - Ferizaj dhe Lipjanin. Gjatë kohës nën okupim, nxënësit e shkollës së mesme që mësonin në Lipjan u përzunë nga shkolla. Deri me fillimin e luftës mësimet i kanë ndjekur në shkollën e lartpërmendur, ku ishin 640 nxënës të shkollës së mesme", tregon ai. Avdullahu ka shtuar se në këtë vatër të diturisë gjatë kohës së okupimit janë zhvilluar të gjitha aktivitetet politike, kulturore dhe sportive këtu, nga e gjithë

Komuna e Lipjanit. "Këtu janë formuar edhe degët e partive politike, ato të sindikatave... Andaj, nuk kishte ditë e as natë që kësaj shkolle nuk i vërsuleshin milicët serbë të cilët i rrihnin dhe arrestonin aktivistët që i gjenin në shkollë. Madje barbarët serbë edhe procesin mësimor e pengonin", ka pohuar Adil Avdullahu. Ai ka thënë se institucionet përkatëse sa më parë duhet ta rinovojnë shkollën e ta shndërronjë në shkollë të mesme apo në fakultet pasi, sipas tij, të gjitha kushtet i plotëson. "Mos të lihet kështu e shëmtuar si është sot. Kjo vatër e diturisë këtu gjendje nuk e meriton", është shprehur ish-drejtori i

shkollës në fjalë, Adil Avdullahu. Ndërsa ish-arsimtari i kësaj shkolle, Ibrahim Ymeri, ka thënë se është një projekt i cili është i hartuar për rinovimin e kësaj shkolle. Pra, sipas tij, këtë do ta financojë një organizatë ndërkombëtare. Mirëpo, se cili do të jetë destinacioni i saj nuk mund ta dijë. "Unë kam propozuar te përgjegjësit e arsimit në Komunën e Lipjanit që shkolla të rinovohet e të bëhet shkollë e mesme bujqësore, sepse i plotëson të gjitha kushtet për këtë drejtim. Ose shkollë e mesme teknike. Të shohim, diçka do të bëhet", ka thënë ky mësimdhënës i shkollës në fjalë.

Tarifa doganore nuk pakëson mallrat esenciale në treg

PRISHTINË, 4 JANAR - Një muaj e gjysmë pas vendosjes së taksës doganore 100 për qind për produktet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, tregu në Kosovë vazhdon të mbetet mjaftueshëm i furnizuar me produkte esenciale. Aktualisht, në tregun tonë mund të gjenden të gjitha mallrat, përfshirë edhe ato nga Serbia e Bosnja, edhe pse importi nga këto dy vende, sipas autoriteteve përgjegjëse në Prishtinë, tashmë është ndërprerë gati në tërësi.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës, por edhe në Odën Ekonomike dhe organizatën "Konsumatori", thonë se gjatë kësaj periudhe nuk është vërejtur mungesë e asnjë produkti bazë, por as produkteve të tjera. Megjithatë, vlerësimet e tyre dallojnë kur bëhet fjalë për arsyet për këtë stabilitet, marrë parasysh se Serbia deri para 1 muaji e gjysmë ishte eksportuesja më e madhe e mallrave në Kosovë.

Elhami Ismajli, zëdhënës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, thotë se produktet nga Serbia dhe Bosnja janë

zëvendësuar menjëherë, pasi janë rritur shkëmbimet tregtare me vende të tjera dhe janë krijuar tregje të reja. "Pas vendosjes së taksës janë krijuar mundësi të reja për eksport dhe menjëherë janë zëvendësuar produktet të cilat janë importuar nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Nga të dhënat statistikore shihet se pas vendosjes së taksës është rritur eksporti në drejtim të Gjermanisë, Italisë, Sllovenisë, Polonisë, Mbretërisë së Bashkuar, Shqipërisë, Maqedonisë etj. Si tregje të reja janë identifikuar shtetet si: Libia, Islanda, Lituania, etj", ka thënë Ismajli. Duke mos mohuar ndikimin e stoqeve të bizneseve, edhe në Odën Ekonomike të Kosovës, stabilitetin e produkteve bazike në treg e lidhin me krijimin e tregjeve të reja.

I pari i këtij organi profesional, Berat Rukiqi, thekson se menjëherë pas vendimit për taksën, Oda Ekonomike u ka dalë në ndihmë bizneseve për të gjetur alternativa të furnizimit, sidomos për produktet esenciale, raporton "REL". "Normalisht, kompanitë kanë pasur edhe



stoqe, por asnjë kompani nuk ka ndenjur duarkryq dhe të presë çfarë po ndodh me taksën. Shumica prej tyre janë përgatitur për një version më të gjatë të zbatimit të taksës, kështu që nuk e besoj se është vetëm për shkak të stoqeve", ka thënë Rukiqi. Por, ndryshe nga dy të parët, në organizatën "Konsumatori" këtë gjendje e lidhin më shumë me, siç thuhet, mbi importin para

vendosjes së taksës apo edhe me kontrabandën sesa me blerjet nga tregjet e reja. Kreu i kësaj organizate, Selatin Kaçaniku, hedh dyshime se biznese të caktuara kanë qenë të informuara për taksën, para vendosjes së saj dhe kanë bërë mbi-import. "Momentalisht, nuk po vërejmë mungesë të ndonjë produkti nga lista esenciale e artikujve, ose nga lista e gjerë dhe kjo më bën

edhe të dyshoj që mos informata ka rrjedhur para aplikimit të taksës dhe dikush ka arritur që në treg të fusë më shumë prodhime të importit sesa që ka nevojë tregu. Unë besoj më shumë në mbi-import dhe në kontrabandë. Nuk po shohim produkte të reja në dyqane, prandaj nuk mund të them se Qeveria dhe bizneset kanë gjetur tregje të reja", ka vlerësuar Kaçaniku.

Studentët e UBT-së vizituan fabrikën 'Birra Peja'



PEJE, 4 JANAR (ER) - Studentët e vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë kanë vizituar fabrikën "Birra Peja", të shoqëruar nga Violeta Lajçi-Makolli, Kastriot Pehlivani,

Fisnik Lahu dhe Emine Daci. Vizita është realizuar në kuadër të lëndëve "Teknologjia e verës dhe pijeve alkoolike" dhe "Proceset themelore në teknologjinë ushqimore".

Studentët e UBT-së kanë parë proceset e prodhimit të birrës, çajit dhe ujit. Koncretisht ata kanë pasur mundësinë të shohin nga afër proceset e prodhimit, duke filluar nga kontrolli i lëndës së parë, proceset e shkëmbimit

të nxehtësisë, pompimit, proceset e fermentimit, pastrimit, kullimit, analizat laboratorike, si dhe procese të tjera të përpunimit, e deri te procesi automatik i paketimit me teknologjitë më moderne në rajon. Në fund,

pjesëtarët e stafit të fabrikës "Birra Peja" u shpjeguan studentëve në detaje për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të prodhimit deri te procesi i plasimit në treg të produkteve.

Çdo vit pensionohen rreth 60 të punësuar në ndërmarrjen "Trepça"

PRISHTINË, 4 JANAR - Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës", Ardian Syla, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se çdo vit përafërsisht pensionohen rreth 60 të punësuar

në ndërmarrjen "Trepça", por që këta deri më tani nuk janë zëvendësuar me punëtorë të rinj. "Duhet potencuar se çdo vit përafërsisht pensionohen rreth 60 të punësuar, të cilët

deri më tani nuk janë zëvendësuar", ka thënë ai. Ai ka treguar se viti 2018 ka qenë ndër vitet më të rëndësishme në historinë e ndërmarrjes "Trepça", pasi në prill, me vendim të kryemi-

nistrisë të Kosovës, për herë të parë emërohet bordi mbikëqyrës si organi më i rëndësishëm i ndërmarrjes i paraparë me Ligjin për "Trepçën".



Viti 2019, vit i një krize të re ekonomike?

Krizat ekonomike janë të shpeshta. A do të ketë krizë edhe në vitin 2019? Pas nesh kemi lënë një vit me shumë sfida, ndërsa këtë vit sfidat do të jenë edhe më të mëdha

Henrik Bohme /DW/

Profetët e krizave e kanë të lehtë: Çdo herë ata e vizatojnë një djall në mur dhe thonë se kriza dhe thyerjet ekonomike në vitin e ardhshëm do të jetë edhe më të rënda. E më pas kur vërtet ndodhë diçka thonë: E shihni, ju kemi thënë me kohë! Ata shkojnë nëpër vende të ndryshme, përhapin frikë dhe shesin librat e tyre. Por nëse shikon gjendjen e tanishme ekonomike, në fund të vitit 2019 mund të ketë vërtet një Crash ekonomik! Probleme të pazgjithura ka gjithandej. Kaosi rreth Brexitit, populistët në Itali, lufta tregtare SHBA-Kinë. Në fakt, askush nuk do të donte të paramendonte një recesion të ri në Evropë, sepse pasojat mund të jenë të paparashikueshme. Banka Qendrore Evropiane e ka shpenzuar municionin dhe tani ka mbetur peng i politikës së Draghit, me një përqindje zero të interesit. Mosveprimi i Draghit paraqet një bazë të fuqishme për një krizë të re.

Prognozat e zymta

Administruesi më i madh botëror i pasurive Blackrock, ka

paralajmëruar investitorët që të mos blejnë aksione në tregjet evropiane. Rreziku është tepër i madh, shanset për fitim janë tepër të vogla. Duhet të shqetësohemi nëse investitorët sërish i kthehen më fuqishëm blerjes së bonove amerikane, me shpresë se atje do të kenë më shumë përfitime. Shenjat për një krizë të re janë të qarta. Por shqetësimi më i madh është mali i borxheve në mbarë botën. Prej vitit 2007, borxhet në botë janë rritur për 42 % dhe aktualisht, borxhet kapin një shumë prej 237 bilionë dollarë, që është një shumë jashtëzakonisht e lartë. Investitorët kanë futur vetëm në Wall Street një kapital prej 670 miliardë dollarë. Ata spekulojnë me para të huazuara. Një bombë e kurdisur!

Bota sot ka më shumë borxhe se në kohën e krizës. Varësisht nga burimi, thuhet se borxhet e përgjithshme kapin një shumë prej 225 % -245 % të fuqisë ekonomike botërore. Vetëm sa për shpjegim: Në Eurozonë shtetet përballen me pakënaqësi, në qoftë se borxhet e një vendi janë më të larta se 60 %. Ndërkohë që borxhet globale porriten më shpejtë se shkalla e zhvillimit ekonomik. Rritja e viteve të fundit e ka pasur një çmim të lartë.



Fatura duhet të paguhet


Nëse kjo fluskë pëlçet, që me siguri do të ndodhë, atëherë duhet të jenë të kënaqur të gjithë ata të cilët janë përgatitur mirë. Të tjerët, do të përballen me pasojat e rënda. Shtetet e futura tepër në borxhe nuk mund të llogarisin me paketa të

reja ndihmash. Ndërkohë që BQE nuk do të ketë masa të reja në dorë për nxitjen e zhvillimit ekonomik, për shkak se interesi edhe tani është zero.

Amerikanët për shkak të politikës së Trumpit me siguri që do të paguajnë një çmim të lartë, për shkak të futjes së re në borxhe. Ndërsa evropianët do të paguajnë për shkak se janë

kënaqur tepër me zhvillimet e mira ekonomike në disa vitet e fundit. Por evropianët nuk janë përgatitur për krizë.

A do të ketë vërtet një thyerje të madhe ekonomike në vitin 2019? Dhe në cilën ditë të javës do të ndodhë një Crash i madh? Këtë duhet t'i pyesni profetët e krizave. Ata mund t'ua thonë shumë saktë!



Vetëvendosja dyshon se ka pasur keqpërdorime në tenderin e qumështit për fëmijët

PRISHTINË, 4 JANAR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje (LV) nëpërmjet një komunikate për medie ka hedhur dyshime se ka pasur keqpërdorime në tenderin e qumështit për fëmijët në kryeqytet. Sipas Vetëvendosjes, në periudhën 2014-2015 në tenderin për qumësht për klasat e para deri te të pestat oferta për një qumësht të vogël ka qenë 10 centë dhe se fitues i këtij tenderi ka qenë "Devolli group" Sh. P.K, me qumështin "Vita", ku vlera e përgjithshme e kontratës ka qenë 200 000 euro, kurse për vitin 2018 i njëjti tender me të njëjtin numër të njësisë, për të njëjtin numër të nxënësve i ka kushtuar komunës 733 698 euro. "Për vitin 2018 i njëjti tender me të njëjtin numër të njësisë, për të njëjtin numër të

nxënësve i ka kushtuar komunës 733 698 euro. Për të njëjtat specifikacione, i njëjti paketim dhe e njëjta kompani prodhuese, pra qumështi 'Vita' nga 'Devolli group' Sh. P. K. Vetëm se kompania prodhuese nuk ka marrë fare pjesë, edhe pse ka qenë përfituese e tenderit të parë. Kjo është rrjedha e ngjarjeve me të cilën është dëmtuar buxheti i komunës, pra paratë e qytetarëve për 530 000 euro. Tenderi paraprak në periudhën 2014-2015 ka qenë me vlerë 200 000 euro. Në shpalljen e tenderit për vitin 2018 vlera e parashikuar e tenderit është bërë 730 000 euro pa asnjë studim apo analizë. Domethënë, 530 000 euro më shumë", është thënë në komunikatën e LV-së.



Prokuroria Themelore në Gjiilan në 2018-n ka kryer mbi 98 për qind të lëndëve

GJILAN, 4 JANAR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjiilan përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se gjatë vitit 2018 ka përbushur me sukses detyrimet kushtetuese dhe ligjore për ndjekjen pa kompromis të kryerësve të veprave penale, duke garantuar në të njëjtën kohë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. "Në vitin 2018 kjo prokurori ka treguar efikasitet të lartë të kryerjes së lëndëve, me mbi 98 për qind të vendosura dhe të dorëzuara në Gjykatën Themelore në Gjiilan, ku në shkallën e kësaj përqindje të lartë, përveç ngritjes së aktakuzave, ka pasur edhe pushime të hetimeve dhe hedhje të kallëzimeve penale.

Prokuroria Themelore në Gjiilan, në tri departamentet e saj, Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për Krime të Përgjithshme dhe Departamenti për të Mitur dhe me gjithsej 17 prokurorë, përfshirë edhe kryeprokurorin e saj, gjatë vitit 2018, ka pranuar 2 592 kallëzime penale, të natyrave të ndryshme, me gjithsej 3 255 persona, me ç'rast në vitin 2019 janë bartur vetëm 44 lëndë, me gjithsej 65 persona", është theksuar një njoftimin për media. Në këtë njoftim thuhet se prioritet i rëndësishëm i veprimtarisë së Prokurorisë Themelore në Gjiilan ka qenë dhe mbetet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në

veçanti korrupsionit në nivele të larta dhe në sistemin e drejtësisë. "Gjithashtu, prokuroria ka qenë e përkushtuar edhe për kryerjen e kallëzimeve penale, përmes procedurave alternative siç janë: marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë, ndërmjetësimet, pezullimet dhe propozimet për dhënien e urdhrave ndëshkimore. Rezultate evidente kjo prokurori ka pasur edhe sa i përket konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurive (sendeve) me të cilat është kryer vepra penale dhe pasurisë e cila është fituar me kryerjen e veprave penale", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Gjiilan.



Kryesia e LDK-së bën homazhe te varri i Tahir Zemajt

DEÇAN, 4 JANAR (ER) - Një delegacion i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i udhëhequr nga nënkryetari Haki Rugova, të premtën në Strellc të Deçanit ka bërë homazhe te varri i kolonel Tahir Zemajt

në 16-vjetorin e vrasjes së tij. Tahir Zemaj është vrasur në një moment prite në orët e hershme të mëngjesit të 4 janarit të vitit 2003, kur vetura e tij ishte goditur pamëshirshëm nga një

breshëri plumbash, duke ia marrë jetën Tahir Zemajt, të birit të tij Enisit dhe kushëririt të tij, Hasanit. Vrasësit e tij ende nuk janë gjetur dhe nuk janë dënuar nga organet e drejtësisë.

Fillon nënshkrimi i peticionit 'Ta mbrojmë Erenikun'

Junik, 4 janar (ER) - Qytetarët e Komunës së Junikut të premtën kanë filluar ta nënshkruajnë peticionin "Ta mbrojmë Erenikun". Kryetari i kësaj komune, Agron Kuçi, ka qenë personi i parë që ka nënshkruar këtë peticion. Me anë të këtij peticioni qytetarët e Komunës së Junikut kanë mundësi ta shprehin pakënaqësinë e tyre për marrjen e burimit të ujit të Erenikut të vogël nga Komuna e Gjakovës. "Peticioni do të vazhdojë deri më 18 janar para objektit të Komunës së Junikut. Po ashtu, të gjithë qytetarët kanë mundësi ta marrin formën e peticionit në shtëpi dhe ta nënshkruajnë familjarët e tyre. Peticioni mund të merret në Zyrën e Tatimit në Pronë në Komunën e Junikut", është thënë në njoftimin për media të Komunës së Junikut.



Gjithashtu, në këtë njoftim bëhet me dije se Komuna e Junikut nuk është kundër furnizimit me ujë për fshatrat e Gjakovës, por është kundër degradimit të vazhdueshëm që Komuna e Gjakovës dhe KRU Gjakova po i bëjnë mjedisit dhe tendencës së tyre që në kundërshtim me Ligjin për Ujërat të Kosovës dhe Konventave Ndërkombëtare për ujërat t'ia ndërrojnë rrjedhën ujit dhe ta marrin atë kundërligjshëm.

Narkoza e vizave - mit apo realitet (9)



Shkruan: Agron HOTI

Fundi i botës

Po thuhet nga qarqe të caktuara se "nëse nuk liberalizohen vizat nuk është fundi i botës". Është fakt se nuk është. Por pyetja që duhet të shtrohet është "se nëse liberalizohen vizat a është fundi i botës"? Lëvizja e lirë e njerëzve është fundamenti i BE-së, sepse pikërisht duke mundësuar lëvizjen e lirë qytetarëve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit BE arriti këtu ku është sot. Prandaj, vazhdimi i izolimit të Kosovës do ta rrisë pakënaqësinë qytetare, do t'i fuqizojë forcat politike populiste në Kosovë me pasojat e të cilave vendet e BE-së veç janë duke u përballur, do të zvenitë dukshëm mbajtjen gjallë të perspektivës evropiane dhe do të mund të sillte probleme të tjera me efekte rajonale. Dhe kjo, sigurisht se do të binte ndesh me zhvillimet pozitive në Maqedoni pas ndryshimeve kushtetuese për emrin, me reformën në drejtësi dhe integrimin evropian të Shqipërisë, me orientimin pro-perëndimor të Qeverisë së Malit të Zi dhe sigurisht do të binte ndesh me tërë pritjet e Procesit të Berlinit për përmirësim të infrastrukturës së gjithëmbarshme në rajon, diçka që i ka munguar dhe ende i mungon rajonit.

Dialogoni me Serbinë se 'bëhet mirë'

BE-ja vazhdimisht na porosit që të dialogojmë me Serbinë. Dhe ne vazhdimisht dialogojmë, pa marrë parasysh çmimin që paguajmë para qytetarëve tanë, të cilët nga mospozicionimi i qartë i BE-së në këtë proces, çdo ditë e më tepër dëshpërohen për këtë dramë me Serbinë, të cilës nuk i shihet fundi. Ka mbi 15 vite që Kosova vazhdimisht harxhon energji të paparë duke dialoguar me Serbinë, në vend që të merremi me problemet reale të qytetarëve tanë.

Dhe nga ky dialog i pafund arrijmë marrëveshje me Serbinë për mospengim të njëri tjetrit në anëtarësime dhe integritet të ndryshme nëpër mekanizma të ndryshëm rajonal dhe ndërkombëtarë,

ndërkohë që Serbia haptazi pengon Kosovën në të gjitha përpjekjet e saj për anëtarësime e integritet, pra shkel tërësisht marrëveshjet.

Pra, nuk duhet të mendohet dhe kalkulohet se mosliberalizimi i vizave mund të sjellë rezultate më të mira në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë duke përdorur mosliberalizimin si presion nga ana e BE-së. Përkundrazi, mosliberalizimi i vizave vetëm sa do të zbehtë këtë proces, sepse qytetarët e Kosovës me të drejtë do të shprehnin shqetësimin se Serbia edhe pse vazhdimisht po e pengon Kosovën, ajo (Serbia) po avancohet në rrugën e saj drejt BE-së.

Ndërkohë Kosova, edhe pse po investon jashtëzakonisht shumë elan politik në bisedimet me Serbinë, nuk po merr asgjë nga BE. Pra, kjo qasje politikisht kalkulative e BE-së nuk pritet të sjell fryte kuptimplotë. Absurdi është kur Serbisë i thuhet që në vitin 2025 mund të anëtarësohet në BE, kurse Kosovës që ka qenë e terrorizuar dhe gjenociduar që mbi 100 vite nga Serbia nuk i hiqen as vizat e mos të flasim për anëtarësim në BE. Pra, BE i kërkon aq shumë kushte Kosovës për liberalizim të vizave, sa Serbisë dhe vendeve të rajonit nuk u kërkon të tilla për anëtarësim në BE.

Rasti më tipik është kur Serbia haptazi lobon për tërheqje të njohjeve të pavarësisë së Kosovës nëpër shtete të ndryshme të botës, kryesisht nëpër ato shtete që kanë pasur raporte të mira me Jugosllavinë e sunduar prej serbëve, pastaj pengon Kosovën për t'u anëtarësuar në UNESCO, Interpol dhe iniciativa të ndryshme rajonale.

Për më tepër, Serbia nuk zbaton as edhe një marrëveshje të vetme të arritur gjatë dialogimit me Kosovën, mbështet haptazi strukturat

ilegale në Veri të Kosovës dhe e tëra kjo bëhet para syve të BE-së. Nëse Kosovës i kërkohet të fuqizojë Sundimin e Ligjit dhe Serbia haptazi pengon shtrirjen e juridiksionit të Kosovës në veri të saj, atëherë si të fuqizohet Sundimi i Ligjit, përfshirë sistemin e drejtësisë, kur Serbia bën obstrukcione të vazhdueshme?!

Pastaj, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina vazhdimisht shkelin Marrëveshjen e CEFTA-s dhe BE as edhe një herë të vetme nuk mori masa ndaj tyre. Pyetja që shtrohet nga çdo qytetar i Kosovës është se si do të mund të zhvillohet ekonomiksht Kosova kur fqinjët e saj pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave?! Pra, Serbia dhe Bosnja vazhdimisht janë rreshtuar kundër trendeve globale për krijimin e Zonave të Tregtisë së Lirë (Free Trade Areas) dhe kjo asnjëherë askujt nuk i bënte përshtypje.

Dhe kur Kosova rriti tarifën vjen menjëherë reagimi nga Brukseli. Ne të gjithë e dimë që ekonomitë e vogla duhet të hapen sepse përndryshe nuk do të mund të mbijetojnë, por ama Kosovës iu shtjerrën të gjitha mundësitë ligjore për të detyruar Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën që të zbatojnë marrëveshjen e CEFTA-s. Kosova nuk ngriti taksat pse deshi, por sepse iu imponua nga destruktiviteti konstant i Serbisë me shumë fytyra: një fytyrë vëllazërore bën për Rusinë, një fytyrë përfituese kamufilon për BE-në, një kinse-joshëse për Shqipërinë, një dërrmuese për Kosovën dhe një kukuvajkë-vajtuese në Kombe të Bashkuara siç vazhdimisht e kanë pasur traditë shtetërore dhe shoqërore.

Përkundër këtyre obstrukcioneve konstante që bën Serbia, Kosovës vazhdimisht i kërkohet që të vazhdojë dialogun me Serbinë, ndërkohë që BE nuk bën as edhe një hap të vetëm

në favor të Kosovës. E rasti i liberalizimit të vizave është rasti më tipik. Ka një tendencë të pathënë që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Dhe kjo ndodh edhe sot, derisa Serbisë iu hoqën vizat nuk u kërkua kurrfarë dialogimi me Kosovën dhe as nuk u la të nënkuptohej. Madje asaj iu hoqën vizat pa e definuar qartë kufirin me Kosovën.

Prandaj, qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë të mbesin edhe më tutje të izoluar për shkak të paaftësisë së BE-së për të sanksionuar Serbinë për veprime ekstremist destruktive dhe për shkak të problemeve të brendshme që kanë institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare të saj. E duhet ditur, që edhe pse problemet e kanë shoqëruar BE-në qysh prej filleve të saj, ajo vazhdimisht, kuptohet kur ka pasur vullnet politik, ja ka dalë që të ecë përpara me projektin e zgjerimit, pra me përfshirjen e shteteve të reja në gjirin e vet. Çdo tendencë për ndalje të këtij projekti do të jetë fatale për BE-në, ashtu sikundër që do të jetë edhe për rajonin.

Kush i ndali hetimet?

Pse nuk përmenden pikat e forta kur flitet për viza?! Kosova dha shembullin e vetëm në botë kur bashkëpunoi pa asnjë hezitim me Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës për Krime Luftë në Ish-Jugosllavi. Kosova bashkëpunoi ngushtë me UNMIK-un dhe Tribunalin e Hagës pa asnjë rezervë në lidhje me gjoja krimet e luftës. Vetë fakti që Parlamenti i Kosovës ka miratuar ligjin për themelimin e Gjykatës Speciale tregon që bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare në hetimin e gjoja krimeve të luftës asnjëherë nuk ka munguar nga ana e Kosovës. E këtë shembull të Kosovës nuk e ka dhënë askush në rajon dhe Evropë, e besa edhe në botë.

Pra, ne bashkëpunuam sepse ishim të bindur që bëmë luftë çlirimtare, se u mbështetëm fuqishëm nga NATO dhe diplomacia botërore për të çliruar Kosovën. Ku ka ndodhur kjo? A ka ndodhur në ndonjë vend të botës kjo?! Ndërkohë që në vatra tjera siç ishin Nazistët, Japonezët, Kmerët e Kuq, Ruanda, krimet e Stalinit, Serbët, të gjitha tentuan të kamuflohen e t'i ikin drejtësisë ndërkombëtare për terror e gjenocid ndaj popujve të ndryshëm.

A s'entoi ose a e dënoi kush Rusinë për terrorin sistematik që ushtronte në Kaukaz?! Sa e

sa krime tjera kundër njerëzimit kanë ndodhur në botë prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot dhe për të cilat drejtësia kurrë nuk mundi ta thotë fjalën e vet?! E njëra prej arsyeve pse drejtësia nuk e tha fjalën e vet është fakti se vazhdimisht mungoi vullneti politik për këtë, diçka që Kosova asnjëherë nuk e ka demonstruar.

Shqiptarët e Kosovës, edhe pse luftuan për çlirimin e vendit të tyre, sepse lufta u imponua nga Serbia, kurrë nuk i ikën drejtësisë. UNMIK-u kishte pushtet pothuaj absolut dhe mund t'i kryente hetimet, t'i sqaronte dyshimet eventuale që padrejtësisht vazhdojnë t'i ngarkohen sot.

Edhe EULEX-i kishte të drejtë të plotë të hetonte, arrestonte dhe burgoste këdo që donte në Kosovë sa u përket krimeve të luftës dhe rasteve të korrupsionit. Pse nuk e bëri?! Të gjitha mjetet i kishte në dispozicion ashtu sikundër që gëzonte autoritetin ligjor, të cilit për hir të së vërtetës Kosova ia pati dhënë vetë përmes votimit në Parlament. Pra, UNMK-u nuk veptoi, pastaj EULEX-i dështoi, ndërkohë që Gjykata e Hagës ishte instanca tjetër ndërkombëtare që kishte plotësisht duart e lira për të hetuar Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

E sa i përket EULEX-it, kemi qenë dëshmitar edhe të situatave qesharake, kur ky mision, në njërin anë synonte fuqizimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, e në anën tjetër kur shpërthenin aferat e ndryshme korruptive, ftoheshin institucionet e Kosovës që të hetojnë EULEX-in, pra situata që të çmendin dhe që për një qytetar të zakonshëm janë të pakuptueshme. Qytetarët e Kosovës kanë pritur që EULEX-i të forcojë drejtësinë e Kosovës, e jo Kosova të forcojë EULEX-in.

Pra, nëse ka pasur ndonjë shtet në Evropë që ka pasur mundësi të pastrohet nga drejtësia, atëherë Kosova ka qenë rasti më ideal, pasi kishte mekanizma të shumtë siç ishin: drejtësia e UNMIK-ut, drejtësia vendore, ajo e EULEX-it, Tribunali i Hagës dhe tash Gjykata Speciale. Këtë nuk mund ta mohojë askush. E nëse të gjithë këta mekanizma nuk ja kanë dalë të bëjnë asgjë, atëherë çdo qytetar ka të drejtë, që së paku për gjoja krime të luftës, ta shohë me dyshim çdo mekanizëm ndërkombëtar të ngritur për këtë çështje.

(Vijon)



Demokrati Jim Webb, kandidat për shef të Pentagonit

WASHINGTON, 4 JANAR - Gazeta "New York Times" raportoi se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, po e shqyrton emërimin e ish-senatorit demokrat, Jim Webb, për sekretar të ardhshëm të Mbrojtjes.

Sipas raportit, zyrtarë të administratës e kanë kontaktuar Webb për mundësinë e emërimit në pozitën

e shefit të Pentagonit.

Patrick Shanahan, ish-shef ekzekutiv i kompanisë së avionëve Boeing, është aktualisht ushtrues i detyrës së sekretarit të Mbrojtjes.

James Mattis ka dhënë dorëheqje nga pozita, muajin e kaluar, në shenjë proteste ndaj politikave të presidentit Trump.

Webb ka shërbyer si sekretar i

Marinës nën presidentin republikan, Ronald Reagan.

Webb, 72 vjeç, është një veteran i dekoruar i luftës që ka shërbyer në Luftën e Vietnamit.

Shtëpia e Bardhë nuk e ka komentuar raportin në "New York Times", ndërsa gazeta tha se Webb nuk i është përgjigjur kërkesës për komente.



Anëtarja myslimane e Kongresit e mbuluar me shami

Ilhan Omar një nga dy gratë myslimane, të parat që shërbejnë në Kongresin amerikan, e mbulon kokën me shami, por teknikisht kjo është e ndaluar sipas rregullave të Dhomës së Përfaqësuesve

WASHINGTON, 4 JANAR - Ilhan Omar po ia ndryshon pamjen Kapitolit. Një nga dy gratë myslimane, të parat që shërbejnë në Kongresin amerikan, e mbulon kokën me shami. Por teknikisht kjo është e ndaluar sipas rregullave të Dhomës së Përfaqësuesve.

Kongresi i 116-ë do të jetë ndër më të larmishmit. Tani që demokratët morën kontrollin e organit të tyre legjislativ, ata do t'i ndryshojnë rregullat në mënyrë që ta reflektojnë këtë realitet.

Rregulli që do ta kishte ndaluar Omar të mbante shami koke,

ose hixhab, u vendos para 181 vjetësh kur përmbajtja e Kongresit dukej shumë ndryshe. Gratë dhe pakicat nuk e kishin mundësinë të shërbenin si anëtarë të tij. Kur ligjvënësi përcaktuan se "çdo anëtar duhet ta ketë kokën të pambuluar gjatë seancave të Kongresit", ata i referoheshin praktikës së zakonshme të burrave në shekullin e 19-të për mbajtjen e kapelave. Rregulli nuk ishte vendosur për të diskriminuar pakicat fetare.

Megjithatë edhe atëherë ky rregull shkaktoi debate. Disa anëtarë argumentuan se veshja



e kapelës ndiqte një traditë të rëndësishme në Parlamentin britanik që simbolizonte pavarësinë nga monarku. Të tjerë dhanë një argument edhe më praktik, duke pyetur ku mund t'i linin kapelat.

Megjithatë rregulli mbeti. Në

seanca ndalohen gjithashtu cigaret, ushqimi, pijet dhe celularët.

Anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve kanë një avantazh ndaj kolegëve të Senatit: ata janë lejuar gjithmonë të sjellin fëmijët në sallën e

seancave.

Mbulimi i kokës është përdorur edhe në shenjë proteste. Në vitin 2012, kongresisti demokrat, Bobby Rush i Illinoisit u përzu nga salla e seancës pasi po e mbante në kokë kapuçin e një puloveri, si shenjë proteste pas vdekjes së adoleshentit afrikano-amerikan Trayvon Martin, që u vra nga George Zimmerman dhe kishte kapuçin në kokë kur u vra.

Në Twitter, Ilhan Omari që ka lindur në Somali tha se do të kërkonte t'i jepej fund ndalimit. Së bashku me kongresistin nga Masaçusets Jim McGovern dhe kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi nga Kalifornia, Omar po paraqet një propozim sipas së cilit, të bëhet një përjashtim nga ky rregull për mbulimin e kokës për arsye fetare ose mjekësore.

Trumpi po vlerëson tërheqjen ose jo të trupave nga Afganistani



WASHINGTON, 4 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, është në "proces të vlerësimit" për tërheqjen ose jo të disa trupave amerikane nga Afganistani, tha nënpresidenti amerikan, Mike Pence.

Komentet e tij vijnë pas raporteve se Trumpi ka urdhëruar Pentagonin që të përgatitet për tërheqjen e 7,000 trupave nga Afganistani - rreth gjysmës së kontingjentit amerikan në

këtë vend.

"Në kohën që po flasim, presidenti është në proces të vlerësimit", tha Pence.

Këtë javë, Trumpi iu bëri thirrje vendeve të tjera, në veçanti Rusisë, Pakistanit dhe Indisë, që të përfshihen më shumë në luftimet në Afganistan.

"Përse Rusia nuk është atje? Përse jo India? Përse jo Pakistani? Përse jemi ne, duke qenë 6,000 milje larg", pyeti Trumpi.

Në Afganistan ndodhen rreth 14,000 trupa amerikane që aktualisht udhëheqin përpjekjet e NATO-s për të trajnuar dhe këshilluar trupat lokale.

Fuqitë perëndimore janë të pranishme në Afganistan qysh në vitin 2001, kur i kanë rrëzuar talibanët nga pushteti.

Muajin e kaluar, Trumpi ka vendosur për tërheqjen e të gjitha trupave nga Siria, duke shkaktuar shqetësim tek aleatët.

Konservatorët, skeptikë për planin Brexit

LONDËR, 4 JANAR - Plani i kryeministres Theresa May për të miratuar në parlament marrëveshjen për daljen e Britanisë nga BE-ja, mori një tjetër goditje të premtën.

Sipas një sondazhi të kompanisë "YouGov", shumica e anëtarëve të partisë së saj e kundërshtojnë marrëveshjen dhe preferojnë të largohen nga unioni, pa një të tillë.

Nëse ligjvënësit nuk e miratojnë

atë, ekonomia e pestë në botë është drejt rrugës për t'u larguar nga Bashkimi Evropian më 29 mars, pa marrëveshje.

Ky skenar do të ishte një makth për shumë biznese të mëdha që i druhen ndërprerjes së tregtisë.

May i duhen 318 vota për miratimin e marrëveshjes që ka arritur me Brukselin në muajin nëntor.

Por 117 nga 317 ligjvënës të

partisë së saj Konservatore, votuan kundër May në një mocion besimi të zhvilluar më 12 dhjetor.

Kjo do të thotë se kryeministres britanike i nevojitet mbështetja e disa prej 257 ligjvënësve të Partisë Laburiste në opozitë. Por këta të fundit janë shprehur se nuk do ta mbështesin marrëveshjen. Sondazhi i së premtes ofroi një panoramë të sfidës me të cilën përballet May.



Në 50-vjetorin e demonstratave të vitit 1968 (1)

VITI 1968, VIT I KTHESËS SË MADHE HISTORIKE



Selatin NOVOSELLA

Viti 1968 në historiografinë botërore tashmë ka hyrë si "viti i demonstratave". Kështu mund të thuhet për faktin se gjatë këtij viti u zhvilluan demonstrata gjithandej nëpër botë si dhe në disa qytete të Jugosllavisë dhe në hapësirat shqiptare nën administrimin e këtij shteti

1. Demonstratat e vitit 1968 në Çekosllovakia pas pushtimit nga Traktati i Varshavës

Traktati i Varshavës, i cili ishte bashkim politik-ushtarak i Bashkim Sovjetik, Çekosllovakisë, Polonisë, Hungarisë, Rumanisë, Gjermanisë Lindore, Bullgarisë dhe Shqipërisë, do të intervenojë, përkatësisht, do ta pushtoj ushtarakisht Çekosllovakinë, në verën e vitit 1968, si kundërshtim i një lëvizjeje liberale në këtë shtet. Populli liridashës i këtij vendi do të ngritet në demonstrata masovike në kundërshtim të këtij akti të papresedan kur një aleancë e pushton pjesëtaren e vet! Ndonëse kishte shumë qytetarë të Çekosllovakisë që u mbytën, u plagosën, u torturuan dhe u burgosën nga ushtria "aleate" sovjetike, megjithatë, do të jetë akti heroik i studentit Jan Pallah, që në shenjë të protestës, do të del para tankeve ruse, në Pragën liridashëse, dhe do ta vetëdijet me benzinë!

Ndonëse Shqipëria ishte tërhequr nga Traktati i Varshavës në vitin 1961, pas këtij pushtimi klasik të njërit prej "aleatëve" të këtij formacioni më të fuqishëm në botë, par Paktit Veriatlantik, përkatësisht, NATO-s, Shqipëria, në shenjë mospajtimi dhe proteste, përfundimisht, do të braktis këtë aleancë.

2. Demonstrata e vitit 1968 për barazi racore në SHBA dhe kundër luftës në Vietnam

Gjatë këtij viti historik, në vitin, 1968, SHBA-ja po ziente nga protestat, grevat dhe demonstratat milionëshe të zezakëve të Amerikës duke kërkuar të drejtat e mohuara politike, shoqërore dhe kulturore. Në ballë të kësaj lëvizjeje ishte vënë, duke u shndërruar në metaforë të njeriut liridashës, Martin Luter - "Kingu". Paralel me këtë lëvizje masovike pa vazhdonin edhe demonstratat masovike, posaçërisht të rinisë studentore

amerikane, kundër luftës në Vietnam. Në mesin e këtyre demonstratave do të bie në sy edhe Bill Klinton, presidenti i më vonshëm i SHBA-ve dhe përkrahësi i flakët i vendimit për bombardimin e Serbisë gjatë vitit 1999, në mbrojtje të lirisë së Kosovës. Biografët e Klintonit, do ta theksojnë se gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale në SHBA, me rastin e zgjedhjes së Klintonit president, do të akuzohet ai nga rivalët e tij se i "kishte tradhtuar interesat e shtetit amerikan" pse kishte qenë në ballë të demonstratave, në vitin 1968, dhe kishte kundërshtuar edhe shkuarjen e tij në luftën në Vietnamit.

3. Demonstratat e rinisë studentore në Evropën Perëndimore të vitit 1968

Rinia studentore e shteteve demokratike të Evropës Perëndimore, në vitin e madh, vitin 1968, e kishte të zgjidhur çështjen e lirisë kombëtare, çështjen e sistemeve demokratike, çështjen e të drejtave sociale etj. Me parullën e kohës për "liberalizmin e majtë" rina studentore e Evropës Perëndimore, e posaçërisht ajo e Francës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë Perëndimore dhe Spanjës, do të shndërrohet në një lëvizje masovike të paparë pas Luftës së Dytë Botërore. Sidomos universitetet e këtyre shteteve do të shndërrohen në arena të përleshjeve dhe kacafytjeve me arganët e rendit. Do të mbylleshin shumë universitetet, do demonstrohet në qytetet kryesore të këtyre shteteve, do të bëhen barrikada të fuqishme në rrugët dhe udhëkryqet e kryeqyteteve, në Paris, në Londër, në Berlin dhe në Madrid.

Në mesin e demonstratave dhe në ballë të tyre do të jenë: në Paris edhe shkrimtari dhe filozofi, Zhan Pol Sartër; në Londër edhe Toni Bler; në Gjermani edhe Joshka Fisher; ndërsa në Madrid edhe Javier Solana. Thënia "rasti është mbreti i botës!", në rastin e shqiptarëve të Kosovës verifikohet plotësisht. Në çastet vendimtare

për fatin e Kosovës, gjatë vitit 1999, kur qenja shqiptare në Kosovë po rrezikohej si asnjëherë më parë, do të jenë pikërisht këta katër liderë botërorë, studentët e rebeluar të vitit 1968, Bill Klinton, Toni Beler, Javier Solana dhe Joshka Fisher, që do të jetë "kuarteti" vendimtar për vendimin e intervenimit të NATO-s kundër ushtrisë vrasëse serbe.

Për nivelin e organizimit, masovitetin dhe kryengritjen e llojit të vet gjatë këtij vite, vitit 1968, le të theksohet këtu një moment domethënës. Në situatën kur rinisë studentore në Parisit i ishin bashkuar edhe punëtorë e qytetarë të shumtë, me ç'rast thuhej se kalonte numri mbi një milionë pjesëmarrës, kur po rrezikohej edhe qeveria franceze, gjeneralin Sharl De Gol, do ta transferojnë me aeroplan ushtarak në një bazë të NATO-s në Gjermanë Perëndimore.

4. Demonstrata e vitit 1968 në qytetet e Jugosllavisë

Pas rrëzimit nga pushteti të Aleksandër Rankoviçit, më 1 korrik 1966, ministër i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, UDB-së, dhe ndër bashkëpunëtorët më të afërm dhe më të besuar të kreut jugosllav, Josip Broz Titos, ishte ndër një lloj liberalizmi në tërë hapësirat e Jugosllavisë, që nuk kishte ndodhur asnjëherë që nga Lufta e Dytë Botërore. Në rrethana të tilla, por edhe duke marrë si shembull lëvizjen masovike studentore të vitit 1968 gjithandej nëpër botë, siç u theksua në cilat shtete, edhe në kryeqendrën e shtetit jugosllav, në Beograd, dhe në kryeqytetin e Republikës së Kroacisë, në Zagreb, gjatë këtij vit do të organizohen dhe zhvillohen demonstrata të rinisë studentore. Posaçërisht ato të Beogradit ishin shumë masovike dhe të fuqishme.

Masa dhjetëra e mijëra studentëve të Universitetit të Beogradit, në verën e vitit 1968, ia kishte mësyre objekteve shtetërore-qeveritare të Beogradit. Demonstruesit ishin bllokuar në

njërin prej urave kryesore të kryeqytetit jugosllav. Policia e përfurcuar me njësi speciale nuk i kishte lejuar demonstruesit të kalonin Urën mbi Lumin Sava. Dëshmitarët e kohës flasin se do të jetë vendimtare që studentët të mos vazhdimin më tutje takimi i një personaliteti të kohës Vellko Vllahoviç, një ish-luftëtar i Brigadave Vullnetare të Luftës Qytetare të Spanjës.

Fjalët e këtij luftëtari të njohur dhe autoriteti që gëzonte ai tek rinia studentore e Beogradit do t'i ndalojë ata që të mos shndërrohej një kacafytje dhe përleshje në mes rinisë dhe policisë jugosllave, fundi i të cilës përleshje nuk do t'i dihej fundi!

5. Kërkesat e politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë në vitin 1968 për avancimin e statusit të Kosovës në nivel të republikës në ish-Jugosllavi

Që nga viti i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, me ç'rast jashtë trungut etnik shqiptar kishin mbetur pothuaj gjysma e territoreve shqiptare, me po aq popullsi, në jetën politike të shqiptarët kishte lindur një rrymë e re politike, e panjohur më herët, rryma irredentiste, e cila synonte që territoret e mbetura jashtë kufijve politike të Shqipërisë, të çliroheshin dhe t'i ribashkoheshin asaj. Kjo lëvizje politike, që për simbol do ta ketë, fillimisht, ideologun e shquar Hasan Prishtinën, do të organizojë veprimtarinë e saj herë me mjete politike e herë me mjete ushtarake, me synim e cekur më lart. Kështu do të jetë deri në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945, kur shqiptarët e të gjithë hapësirës kombëtare, pra jo vetëm të Shqipërisë së shtetëzuar, por edhe shqiptarët e Kosovës e më gjerë, do të rreshtohen me aleancën antifashiste, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo po ndodhet, kështu, jo vetëm

për ta çliruar Shqipërinë nga pushtimi fashist dhe nazistë, por edhe që në rrethanat e reja historike, pas kësaj lufte të ribashkoheshin territoret jashtë shtetit amë me të. Andaj, me këtë qëllim do të mbahet Kuvendi i Bujanit, ku, në deklaratën e njohur, thuhej se pas çlirimit të hapësirave të Jugosllavisë, të banuara me shumë prej shqiptarësh, d.m.th, edhe Kosova, do të bashkoheshin me Shqipërinë sipas të drejtës ndërkombëtare të vetëvendosjes. Rezultatet e kësaj lufte dhe pasojat e sajë, tashmë, janë të njohura.

Edhe pas ripushtimit të Kosovës nga forcat çetnike-partizane, në dimrin e egër 1944-45, përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera, nuk do të ndërpriten për asnjë çast. Për të arritur qëllim e Lëvizjes Irredentiste, shqiptarët formojnë shumë grupe, organizata dhe parti politike, të cilat, pa përjashtim, organizohen dhe veprojnë në fshehtësi të thellë. Andaj, kjo periudhë e veprimtarisë atdhetare-politike në historiografi do të hyjë si "Lëvizja atdhetare ilegale". Kjo Lëvizje, me të gjitha baticat dhe zbaticat, me të gjitha ngritjet dhe rëniet, megjithatë, nuk ishte ndërprerë asnjëherë. Po t'i referohem të dhënave historike del se në periudhën e pas LDB-së, ndonëse shqiptarët në jugosllavi përbënin rreth 20 përqind të popullsisë, numri i shqiptarëve të burgosur ishte rreth 70-80 përqind nga numri i përgjithshëm i të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi.

Në vitin 1968, siç u theksua më parë, si rezultat i luftës për pushtet dhe si rezultat i ndërrimeve konjunkturale të udhëheqjes jugosllave, vije deri tek rrëzimi nga maja e pushtetit më të lartë të Aleksandër Rankoviçit. Ndonëse të gjitha zezonat që i kishte planifikuar, organizuar, udhëhequr dhe realizuar Rankoviç kundër shqiptarëve i kishte kryer në marrëveshje dhe koordinim të ngushtë me Titon, si do që të jetë, Titoja do ta luaj letrën e njohur në politikë të larjes së duarve nga krimet, ku kishte marrë pjesë edhe vet. Kështu, për të dëshmuar para shqiptarëve se, ja ky ishte "shpëtimtari" i tyre dhe se ajo që kishte ndodhur gjatë aksionit të grumbullimit të armëve nga ta, si dhe presionit të paparë për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi, në Shqipëri dhe shkapërderdhjen në hapësirat tjera të Jugosllavisë, tashti, në vitin 1968, Titoja kishte formuar Komisionet për Ndryshimet Kushtetuese në gjashtë republikat e Jugosllavisë (Serbi, Kroaci, Sloveni, Bosnje e Hercegovinë, Mal të Zi dhe në Maqedoni) si dhe dy krahinat në (Kosovë dhe Vojvodinë). Këtë Komision, në Kosovë, e udhëhiqte Fadil Hoxha - kryetar i Kuvendit të atëhershëm të Kosovës. (Vijon)



E rrallë

Koala e etur pi ujë nga shishja

Një koala e etur është fiksuar në një video duke pirë ujë nga shishja e një gruaje, në mesin e një vale të paprecedentë të nxehti në Australi, duke nxjerrë në pah edhe pasojat e temperaturave të larta mbi jetën e egër. Kontinenti australian po shkrihet në kushte ekstreme të nxehti prej disa ditësh, me Mërkurin në termometër që shënon të paktën 16 gradë celsius më shumë se normalja e këtij sezoni në vend.



FOTO E DITES




Si pasojë e të reshurave të mëdha të borës, disa vetura kanë mbetur të bllokuara në parking në ambientet e Brezovicës.

E jashtëzakonshme

Sonda kineze ulet në anën e padukshme të Hënës

Mediat shtetërore në Pekin kanë njoftuar se një sondë kineze e hapësirës u ul me sukses në anën e padukshme të Hënës, hera e parë në histori. Sonda Chang'e-4 u nis në fillim të muajit të kaluar nga Qendra e Lëshimeve Satelitore Xi-chang në Kinën jugore. Menjëherë pas uljes, sonda dërgoi



një foto të sipërfaqes së Hënës. Sonda do të kryejë studime astronomike, analiza mbi përbërjen minerale të Hënës dhe eksperimente mbi rrezatimin e mjedisit rrethues. Ky është mjeti i dytë kinez i hapësirës që bën ulje të butë në Hënë, pas një sonde lëvizëse në vitin 2013.

BARSOLETA E DITËS



Endriti: Më fal, a ke shkrepëse, bre?
Blendi: Po, more!
Endriti: Mos ke edhe një cigare, bre?
Blendi: Edhe cigare kam. Po, prit, mos dil, ja merre edhe xhakëtën time se ish ftoftë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“THE GRINCH” 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

“THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS” 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

“MORTAL ENGINES” 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

“HUNTER KILLER”,

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Mundohuni të jeni më i pranishëm në familjen tuaj duke organizuar aktivitete të përbashkëta ose diskutuar për tema që iu përkasin të gjithëve.</p>	 <p>DEMI Persona që ju duan ndihen shumë të lodhur nga posesiviteti juaj në çdo çast. Ndryshoni sjellje që të përshtateni me ambientin që ju rrethon.</p>	 <p>BINJAKËT Çështjet delikate dhe me shumë impenjim nuk janë për ju sot. Doni të jeni sa më i qetë dhe të shkëmbeni batuta me miqtë tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Për të ndërtuar diçka nga themelet nuk mund t'ia dilni mbanë i vetëm. Nëse gjeni personat e duhur rezultatet do të jenë të mira.</p>	 <p>LUANI Gati keni arritur qëllimet, por ju mungon vetëm një sforcim i fundit. Do të zgjidhni gjithçka gjatë pasdites.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Jeni të përshtatur me vendin e ri të punës dhe tani po arrini t'i zgjidhni në kohë rekord tuaja. Është interesant fakti që po fitoni terren në kaq pak kohë.</p>
 <p>PESHORJA Nëse nxirrni një listë me prioritetet tuaj sot do të arrini të programoni çdo gjë të saktë. Nëse ia lini rastësisë do të dështoni.</p>	 <p>AKREPI Sot do të merrni frytet e punës dhe të mundit tuaj. Si në karrierë si në familje çdo gjë që keni investuar po ju kthehet me shumë dashuri.</p>	 <p>SHIGJETARI Nuk keni kërkuar shumë për të gjetur si objekt material ashtu edhe për një ndjenjë që doni t'ju rikthehet.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni shumë optimist për të ardhmen tuaj. Mbase sepse keni marrë sinjale të qarta që gjërat do të shkojnë siç e keni menduar.</p>	 <p>UJORI Do të luftoni me paragjykimet dhe sjelljet e të tjerëve karshi një situatë të caktuar sot. Do të arrini t'i bindni ata që keni pranë se gabonin.</p>	 <p>PESHQIT Jeni të përshtatur me vendin e ri të punës dhe tani po arrini t'i zgjidhni në kohë rekord punët. Është interesant fakti që po fitoni terren në kaq pak kohë.</p>

Romanca mes Gigit dhe Zaynit ka përfunduar



Ndoshta nuk e kishit vënë re, por Gigi Hadidi dhe Zayn Malik nuk janë parë pranë njëri-tjetrit që prej muajit nëntor. Thashethemet se çifti është ndarë sërish kanë nisur prej pak kohësh. E gjitha nisi pas mungesës së pranisë së tyre në profilet e rrjeteve sociale


të njëri-tjetrit, si dhe nuk janë fotografuar bashkë prej disa muajsh. Mediat e huaja raportojnë se këngëtari dhe modeluesja mendojnë se qëndrimi larg njëri-tjetrit është gjëja më e mirë që mund të bëjnë për ta shpëtuar marrëdhënien e tyre.

2019-a, viti i miqve të rinj për Dua Lipën



Këngëtarja e famshme me origjinë shqiptare, Dua Lipa, e sheh vitin 2019 si vitin për të bërë miq të rinj. Ajo përmes një postimi në "Instagram" ka bërë me

dije se ka bërë mik të ri këngëtarin e njohur kolumbian J. Balvin. "2019-ta është viti për bërjen e miqve të rinj. Miqësia e vonuar me J. Balvin", ka shkruar këngëtarja.



Bebe Rexha në "kërkim" të një burri

Nëpërmjet një postimi në "Twitter", Bebe Rexha ka lënë të kuptohet se është gati të martohet. "Për burrin tim të ardhshëm: Të lutem eja dhe më gjej sa më shpejt. Të dua!", ka shkruar këngëtarja. Më herët ajo

ka deklaruar se nuk do t'i refuzonte edhe meshkujt shqiptarë. Disa ditë më parë Bebe zbuloi se i kishte propozuar për martesë një burrë me fëmijë dhe që ishte i martuar. Ajo e ka refuzuar pa e menduar dy herë.

Ed Sheeran në gjyq për kopjimin e hitit "Thinking Out Loud"



Një Gjykatë në Amerikë ka hedhur poshtë thirrjen e Ed Sheeran në gjyq për një padi që e akuzon atë për kopjimin e pjesëve të këngës "Let's Get It On" të Marvin Gaye. Në vendimin e lëshuar të enjten, gjykatësi i rrethit Louis Stanton ka bërë me dije se një juri muzikore duhet të vendosë nëse është kopjuar tingulli nga

Ed Sheeran ose jo. Ai ka treguar se ka gjetur ngjashmëri të konsiderueshme në disa prej elementeve muzikore të dy veprave, por Sheeran ka mohuar përdorimin e pjesëve të këngës së vitit 1973 për hitin e tij "Thinking Out Loud". Padia ndaj Sheeran është bërë nga Sony ATV Music Publishing dhe Atlantic Records.



Autor: GAZMEND MORINA	ZË I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT	AKTORI ZHITOPOTOKU (shq.)	KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLLEDHJEJE (sh.shq.)	↓	GËZIM I MADH KALIJUM, IRIIDIUM	EMËR MASHKULLI MYSLIMAN
SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA						
ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË						
GJYQTARI SPORTIV						
PËREMËR PRONOR				ISH BOKSIERI YNË LIKA	BASHKËT. AKTORI RAFUNA (shq.)	
DESPOT						BASHKËT.
ZANORE		KRYEMURG OHAJO, FLORIDA				AKTORI I FAMSHËM ... AFLECK MALI MË I LARTË NË TURQI BASHKËT. ELIZA HOXHA VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA
FLETORË E VOGËL PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE					QYTET NË ZVICËR BAKËR PUNUES	

SUDOKU									
	1			2		6			
		6						9	
8	2		1	9				4	
		1			4				3
	9		5	3				2	
3			7			5			
	7			3	1			5	6
4	8						1		
				4					3

EPOKA E RE	LEGJENDA E FUTBOLLIT NË FOTO	NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE	SHTET FEDERAL NË SHBA	KOHË E NDARË PËR PUNË	I SHKALLËS MË TË ULËT	ELIZABETH TAYLOR	TENISTI I NJOHUR ROGER LARTËSI E NJË LËNGU NË NJË ENË					PRODUKT ZJARRI DJALLËZOR (hebr.)				
DUKURI	○						BANOR I KRYEQYTETI SHQIPTAR FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT						BASHKËT. SHTET FEDERAL NË SHBA			
LËNDË MJEKUJËSE QË HAP APETITIN	○							MINDER I ULËT (vjet.) EMËR YNI MASHKULLI				KËNGËTARJA VALENTINA LUMË I MADH NË AFRIKË				
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT	○					FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART			FLETË LETRE PËR DUHAN	TË ARDHURAT VJETORE TË PAPËS					IPSVICH	
FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË	○					PIKTORI ... VALLA KOMPOZITORI ... KOCI				KOLOS						
LEARNING AIM DATABASE	○			KLUBI FUTBOLLI SPANJOLL VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI						PARAGRAF SKUADËR SPORTIVE (shq.)					FAQE E NJË TRUPI (shq.)	
BASHKËT.	○	SULM RRËSHQANOR I MADH					SHTET NË AFRIKË (pashq.) ZHANËR I MUZIKËS					REGJISORI ... QOSJA QË KA TË BËJË ME ATAVIZMIN				
OLIVER KAHN	○		AKTORI PRAPASHTICA NUKLEARE				JO SHUMË TRAVEL INSURANCE DIRECT				MARC ANTHONY	KËNGËTAR I FAMSHËM AMERIKAN (shqip.) MURGU I VETMUAR				
LLOJ PESHKU	○				LËNG SYRI PORTIERI ... HOWARD (EVERTON)			VLERË, DOBI (vjet.) KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT					TEDI ALVES BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV			
RRETH PREJ DRURI A PREJ METALI QË VË NË LËVIZJE NJË MJET (sh.shq.)	○					KËNGËTARI AMERIKAN ... ROCK DY BASHKËTINGËLLORE			PARAKALIMI USHTARAK I SHKRETUAR; I BRAKTISUR						QYTET NË KOSOVË	
I TURPËROJ	○						KAFSHË PËRTYPËSE SHTËPIAKE SHKRIMTARI ... SHEHU				AKTORJA LONGORIA				BASHKËT. PRAROJ	
EPOKA E RE	OLIVIER MARTINEZ MENDIM			KUNDREJT NËN LITËR, AMPËR, METËR			LITUANIA (shk.) ISMET RAMUSHI					MJET SHPËRTHYES (sh.shq.) LICENSING EXECUTIVES SOCIETY				
DASHURI E THJESHË DHE E PASTËR (libr.)					SUEDIA, ESTONIA	VALUAR DY BASHKËTINGËLLORE				LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.) PAMELA ANDERSON						
RESOR								PRAPË ZANORE					"ZOMERSA" BASHKËT.			
SECILA NGA PJESËT QË FORMOJNË NJË TË TËRË							VENDËS, RRËNJËS (sh.shq.)						SELEN			

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: BARAKA, ABERIM, REFERI, IME, R, TIRAN, O, ABAT, NOTES, BAZEL, FEDERER, HIO, FENOMEN, TIRANAS, R, APERITIV, NIM, RAMA, DIVAN, VAN, ANATI, IKARI, ESAT, TITANI, LAD, MALAGA, ALINE, V, ATAK, LIBERI, ISA, OK, LIRI, PAK, AKON, KRAP, LOT, KIMET, TA, RROTAT, KID, PARADA, I KORIT, DEVE, EVA, SH, OM, MBI, LIT, MINAT, IDIL, ZIER, LIKERI, DIKASTER, APET, ZOM, ELEMENT, ANASIT, SE, ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona 1:914 325 687; KII:536 478 291; KIII:827 196 345; KIV:751 284 963; KV:698 513 724; KVI:342 769 518; KVII:279 831 456; KVIII:483 652 179; KIX:165 947 832.

Intervistë me profesorin, publicistin, dramaturgun Haqif Mulliqi (2)

Në përgjithësi, në dramë, nuk më pëlqen patetika

Bisedoi: Musa KURHASKU

"Epoka e re": Dramat për luftën, përgjithësisht, paraqesin tema të mëdha dramatike. Ju keni shkruar një numër dramash me temë nga lufta e fundit në Kosovë si dhe i keni inskenuar një numër syresh. Por ajo që bie në sy te veprat tuaja është se ju, disi, në mënyrë mjeshitore i jeni shmangur një lloj këci që kanos veprat e këtilla, sidomos në një distancë kohore kaq të shkurtër, por edhe patetikës. Si është të shkruani për tema kaq të mëdha dhe ngjarje që shumë njerëz ende i kanë të freskëta në kujtesën e tyre?

Mulliqi: Nuk do mend se kjo nuk është ndonjë punë e lehtë, ndërsa të gjithë ne që merremi me këto tema, përveçse synojmë të zbardhim ndonjë ngjarje apo edhe të themi diçka për tmerret e luftës, gjithashtu, në këto vepra, deshëm apo nuk deshëm, i parashtrijmë vetes ndonjë vargan pyetjesh aspak të lehta. Punën në dramën me temë luftë, qoftë si shkrimtar apo edhe si regjisor, për mua ka qenë një punë goxha e vështirë në kuptimin se pareshtur veten e kam vendosur në një lloj peshoreje duke i shqyrtuar masat e emocioneve që mund të të kaplojnë kur futesh në epiqendër të problemit të dramës për ta zgjidhur atë. Mua më ka ndihmuar fakti se, në përgjithësi, në dramë, nuk më pëlqen patetika. Ndoshta nga fakti se i këtu jam edhe në jetën e përditshme. Thjesht, e urrej patetikën, ndërsa ajo tek unë, qoftë edhe si shikues a lexues i një drame, nuk prodhon asgjë, përveç një nënqeshjeje të pafshëhur. Mbase, ky është, në esencë, mekanizëm me anë të të cilit njeriu mbrohet nga ajo që mund të konsiderohet manipulim. Unë i përkas një brezi që kemi kaluar shumë thyerje politike dhe shoqërore, por që është rritur në një mënyrë mjaft të profilizuar në kuptimin kulturor. Në një shoqëri që kishte filluar të piqet dhe, shumë shokë të mi, por edhe të tjerë nga brezi i kishim formësuar shijet për kulturën dhe skenën e saj, duke përfshirë këtu, përveç teatrit, edhe filmin, muzikën, letërsinë etj. Besoj se ndonjëherë me e ndonjëherë pa vetëdije ne kemi kultivuar një lloj rezistence përball patetikës ngaqë atë e kemi konsideruar dhe përjetuar si diçka që ishte e gënjeshtërt dhe e panevojshme. Në atë kohë edhe te ne, sikurse edhe në shtetin artificial dhe të padrejtë në të cilin kemi jetuar, në kulturën që mbretëronte aty kishte një dominim të plotë të gjeesteve patetike, sidomos në raport me Luftën (e ashtuquajtur) Nacional Çlirimtare dhe partizanët, liderët e mëdhenj e ata

lokalë, e kështu me radhë, ndaj dhe kishte ardhur koha kur ne më nuk besonim në këto gjëra që për dekada ishin shërbyer si vlera të pakontestuar. Ndaj nuk do mend se nga diçka atje dhe në atë kohë gjithçka zë fill. Më kujtohet kur me një grup të studentëve të Universitetit të Prishtinës në vitin 1985 e kisha vënë në skenë një komedi timen që ishte një reagim i fuqishëm satirik dhe politik ndaj sistemit dhe vlerave që na kishte vendosur të gatshme edhe neve si brez.

"Epoka e re": Është fjala për komedinë "Ali Hoxha, Hoxhë Alia", apo jo?

Mulliqi: Po, po, ajo... Mbase mend se shfaqja kishte bërë një "bum" të vërtetë në kryeqytet dhe se ishte shfaqur për ndonjë 70 herë me radhë. Në vitin 1986 me këtë komedi timen morëm pjesë në Festivalin e Teatrove të Rinjve të Jugosllavisë që mbahej në Mostar. Shfaqja jonë ishte hit i vërtetë i festivalit dhe aty, të thuash i rrëmbyem të gjitha çmimet, që edhe sot më bënë të ndihem mirë. Në rrafshin verbal ne e tallnim Partinë Komuniste dhe aparatçikët e saj, ndërsa në vendosjen skenike, në fakt, mbaj mend se e kisha ndërtuar një sistem ku gjithçka funksiononte mbrapsht dhe për të vënë në lëvizje duheshim bërë të gjitha për ta shtyrë gjithçka, fizikisht, nga pas. Tre muaj më pas me atë shfaqje, mu për shkak të prishjes së tabuve që kisha bërë, më ftuan në edicionin e 29 të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në Novo Mesto të Sllovenisë. Ishte një festival ku për herë të parë ishte ftuar dikush nga pjesa tjetër e Jugosllavisë, siç thoshin ata. Në të përditshëm "Dello" të Lubjanës ishte shkruar se na kishin ftuar si model që t'oi shihnin regjisorët e atjeshëm se si mundet nga temat e zakonshme, të thjeshta dhe krejtësisht lokale, të bëhen vepra të një profili të lartë.

Do të kisha dëshirë që këtu të rikthehem edhe një herë te festivali i Mostarit. Aty kisha kënaqësinë se u njoha me njërin prej komediografët më të mëdhenj kroat, Ivo Breshan. Pakkush prej nesh nuk e ka të njohur komedinë e tij brilante "Hamleti nga Mërdusha e ulët", të cilën, për nevojat e Teatrit Shqiptar të Shkupit, Ramiz Kelmendi e kishte përkthyer si "Hamleti nga Katranica e Poshtme". Me këtë emër është inskenuar edhe në Teatrin Kombëtar të Tiranës. Breshani ishte aty në cilësinë e përzgjedhësit të Festivalit Ndërkombëtar të Splitit. Me të më njohu profesoresha dhe dramaturgia nga Sarajeva, Lubica Ostojiq. Pastaj, me të jemi shoqëruar disa ditë, dhe kjo shoqëri ka vazhduar deri në shuar-



jen e tij të para disa vjetëve, ndërsa Lubica Ostojiq, në një shkrim të gjatë për "Ali Hoxhën..." te revista shumë e njohur "Odjek" nga Sarajeva, më kishte prezantuar si "djaloshi që shkruan në stilin e Ivo Breshanit", e që në atë kohë për mua ishte më shumë se kompliment. Me Ivo Breshanin kemi shkëmbyer shumë ide dhe e kam një numër të madh të letrave që m'i ka dërguar, aso me zarf, por më vonë edhe me postë elektronike. Mendoj se me një redaktim të kujdesshëm do të mund të dilte një libër interesant nga ai letërkëmbim.

Sa i përket pyetjes suaj, janë edhe autorë të tjerë në Kosovë që kanë shkruar për luftën e fundit, për vuajtjet dhe dramën e njerëzve në të. Para së gjithash, këtu do ta përmend Milazim Krasniqin, të dy dramën e tij, "Bryma e vdekjes" si dhe "Një Antigonë e re". Këtë të fundit e kisha pjesë të studimit tim të doktoratës ku i kam bërë një analizë të gjatë. Ndërsa unë do të flisja me këtë rast, sidomos për dramën time "The Kosovars". Këtë dramë e kam inskenuar dy herë: një herë me Teatrin Alternativ të Kosovës (me Ismet Azemin dhe Avni Dalipin), herën tjetër me Teatrin "Dodona" (me Mentor Zymberajn dhe Ismet Azemin). Mendoj se që të dyja herët kemi sjellë diçka të veçantë dhe i jemi afruar asaj që e kemi synuar. Ne me "The Kosovars" kemi marrë pjesë dy herë në festivalin më të madh të teatrit në botë, në atë të Edinburgut (Skoci). Bile, njëherë, më 2004 jemi shpërblyer duke u radhitur në top 10 shfaqjet më të mira të festivalit. Ky është vlerësimi kryesor që bëhet atje nga dy juri të ndryshme: ajo e teatrit skocez dhe e gazetës së përdit-

shme "The Scotsman". Ky ishte një sukses i jashtëzakonshëm por, për fat të keq, këtu te ne në Prishtinë ishte një përpjekje që të na injorojnë sa më shumë që mundeshin. Por, për mua ishte e rëndësishme që për shfaqjen tonë ishte shkruar në gazetën më të njohura evropiane, e në veçanti përshtypje më ka bërë një shkrim i jashtëzakonshëm i Ian Herbert, njërit prej kritikëve më të shquar në botë të teatrit të cilin e kishte botuar te "The Guardian", ku fliste për ne me fjalë të zgjedhura. Me këtë shfaqje kemi qenë edhe në një varg të festivaleve botërore të kategorisë A, që nga Rumania e deri në Egjipt, dhe kjo është përvojë e jashtëzakonshme për ne. Vepër imja tjetër është edhe drama "Gjakova një luftë ndryshe", të cilën e kam punuar në një bashkëpunim të Teatrit të Gjakovës me Teatrin Alternativ Kosova. Kjo është një vepër që trajton problemet e katrahurës së njerëzve gjatë tre muajve të fundit në Gjakovë. Drama është shkruar mbi një ngjarje të vërtetë ku vetëm epilogun ia kam ndryshuar. Mbase mend se Hadi Shehu dhe Jahja Shehu kishin bërë një lojë brilante. Madje, shfaqja ishte aq e mirë saqë në një kritikë të "The Scotsman" të datës 8. 8. 2003 autori do të shkruajë se po që se ndonjëherë në Edinburg kishte ardhur shfaqje që e përplotësonte krejtësisht frymën e festivalit, ajo ishte shfaqja jonë.

"Epoka e re": Cila ishte formula e suksesit të këtyre shfaqjeve?

Mulliqi: Unë mendoj se në këto vepra ia kam dal t'i shmangem patosit, por edhe që gjërat t'i quaj me emrin e vërtetë dhe, duke folur shumë qartë për atë që ka ndodhur në luftën e Kosovës. Mirëpo,

nuk besoj se në këto shfaqje nuk mund të gjendet asnjë çast i cili zgjon ndjenjë të urrejtjes apo edhe ndonjë cjtje hakmarrëse për tmerret që kanë ndodhur. Thjesht, teatri dhe drama nuk mund të jenë afishe politike ngaqë kjo do të ishte diçka vërtetë e tmerrshme. Më ka rastisur që, në festivale të shikoj shfaqje për luftën në ish-Jugosllavi të cilat te shikuesit kanë zgjuar reaksione të tilla. Në këtë rrafsh dominojnë teatërberësit serbë dhe vërtet nuk i kuptoj. Rrethanat e tilla janë një disfatë e teatrit dhe e artit në përgjithësi ngaqë diçka e tillë është në një përplasje totale me esencat humaniste të dramës dhe të teatrit.

Ta realizosh në teatër atë që njerëzit mos të mendojnë dhe mos të ndiejnë nevojë që të mendojnë më thellë, është thjesht një gjest politik

"Epoka e re": Profesor Mulliqi, të kthehem më lart diku: çfarë, sipas jush, është sot qëllimi i teatrit të angazhuar? Mbase mend që, me një rast, në një emision televiziv keni deklaruar se i vetmi teatër që është sot i vlershëm është teatri i angazhuar.

Mulliqi: Po, mirë e keni mbajtur mend. E kam thënë dikur në emisionin tim "Pro arte" që e udhëhiqja në RTK. Pra, meqë e kam thënë unë, edhe mendoj ashtu sepse, secili teatër, nëse është i mirë, në të njëjtën kohë del të jetë edhe i angazhuar në rrafshin shoqëror. Por kjo nuk është diçka shumë e thjeshtë të arrihet sepse jo të gjitha temat që vendosim në skenë janë dhe mund të bëhen të angazhuara në rrafshin shoqëror. Do të thotë se ekzistojnë shfaqje me tema tjetërfare dhe me to mund të bëhen (dhe bëhen) edhe shfaqje të tjera. Këto janë shfaqje, të paktën unë kështu mendoj, pa ndonjë kontekst shoqëror absolutisht, të cilat nuk janë asgjë më shumë përveçse një fakti estetik apo edhe vetëm një akt argëtimi për njerëz. Bile, për të qenë më konkret në këtë që e them, ato janë në një mënyrë të veten fakte politike në kulturë. Sepse t'ia dalësh ta realizosh në teatër atë që njerëzit mos të mendojnë dhe mos të ndiejnë nevojë që të mendojnë më thellë, është thjesht një gjest politik. Dhe, në këtë kuptim duhet theksuar se akëcili akt teatror është, apo të paktën do të duhej të ishte, ndonjë angazhim shoqëror.

"Epoka e re": Jahja Shehu më ka thënë me një rast se me ty ishte lehtë të punohej...

Mulliqi: Edhe me Hadiun dhe Jahjanë ishte kënaqësi të punohet dhe përvojë shumë e mirë. (Vijon në numrin e ardhshëm të gazetës)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BURNLEY - BARNSELY

1

BOURNEMOUTH - BRIGHTON

1

NORWICH - PORTSMOUTH

1

Demaku: Ëndërroj të luaj për Kosovën ose Shqipërinë

"Është një ëndërr për mua dhe një dëshirë e prindërve të mi për t'i përfaqësuar ngjyrat e kombit shqiptar. Dëshira ime është që të luaj për Kosovën ose Shqipërinë dhe ta përfaqësoj atë me dinjitet. Jam mirë në aspektin fizik, sepse vetëm kështu mund të kem rezultatet që dëshiroj", ka thënë Vesel Demaku

Miftar ZAGRAGJA

PRISHTINË, 4 JANAR - Vesel (Blerim) Demaku është talenti i radhës me prejardhje shqiptare që po lë gjurmë në futbollin evropian. Familja e Veselit është nga Abria e Drenasit, kurse jeton dhe vepron në Komunën Baden Niederosterreich në Austri. 18-vjeçari që ka një potencial të jashtëzakonshëm në futboll ka thënë se dëshira e tij është që në të ardhmen të luajë për Kosovën ose Shqipërinë. "Është një ëndërr për mua dhe një dëshirë e prindërve të mi për t'i përfaqësuar ngjyrat e kombit shqiptar. Dëshira ime është të luaj për Kosovën ose Shqipërinë dhe ta përfaqësoj atë me dinjitet. Jam mirë në aspektin fizik, sepse vetëm kështu mund të kem rezultatet që dëshiroj", ka thënë Demaku, i cili është kapiten i Austrisë U-20.

Mesfushori i skuadrës së FC Austria Vienna pas paraqitjeve të mira ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve të njohura. Ai dëshiron që me punë dhe disiplinë të arrijë suksese në lojën e futbollit. "Jam vetëm 18-vjeçar dhe mendoj se më shumë punë dhe stërvitje të kem një karrierë të suksesshme, duke pasur mundësinë që të luaj vetëm në klube të mëdha. Është ëndërr për çdo futbollist. Jetoj me futbollin dhe jam shumë i lidhur pas tij. Mendimi im është se kam shumë talent, por që të bëjë karrierë duhet shumë disiplinë dhe punë. Personalisht, këtë e kam kuptuar edhe në punën time. Ne si familje e duam futbollin dhe synim im është të tregoj pasionin dhe potencialin që kam", ka thënë ai.

Veseli ka lindur më 5 shkurt të vitit 2000, kurse karrierën e filloi para dymbëdhjetë vjetësh në SKV: Altenmarkt Niederosterreich Austri. Në vitin 2006 ai iu bashkua të rinjve në FC Rapid Vienna. Nga viti 2009 deri në vitin 2012 luajti për FC Admira Wacker Modling, para se të kthehej në Rapid. Në vitin 2014 ai u



bashkua me akademinë e FC Red Bull Salzburg. Ai ka kaluar nëpër të gjitha moshat. Ai qëndroi në nëntor 2016 kundër FC Qairat Almaty në skuadrën e ekipit U-19 në Ligën e Rinisë UEFA, me të cilën fitoi në fund të sezonit. Për sezonin 2017/18 Demaku u transferua në FC Austria Vienna. Ai pati një pengesë në fillim të sezonit për shkak se u lëndua dhe është dashur të operohet. Debutimi i tij për Austrinë në Bundesliga erdhi në muajin mars 2018, kur hyri si

zëvendësim për Kevin Friesenbichler në minutën e 79 në FC: St. Polten në ndeshjen e 26. Demaku luajti në nëntor 2014 për herë të parë për një ekip kombëtar, pra për të rinjtë e Austrisë. Në shtator të vitit 2015 u grumbullua për herë të parë në U-16. Në gusht të vitit 2016 ai bëri debutimin e tij kundër Kroacisë për ekipin U-17 të Austrisë. Në shkurt 2018 luajti për herë të parë në përzgjedhjen U-18. Në shtator 2018 bëri debutimin e tij kundër Suedisë për ekipin U-19.

SHKURT

Përforcohet KB Prishtina

KB Prishtina po vazhdon të përgatitet për pjesën e dytë të sezonit në Superligën e Kosovës në basketboll, por edhe për garat e Evropës. Klubi nga kryeqyteti ka bërë të ditur se ka siguruar shërbimet e basketbollit Muhama Ahmed Bashir. "Muhamad Ahmed Bashir lojtari më i ri i Z Mobile Prishtina. Ahmed Bashir është i gjatë 2.01 m, peshon 95 kg dhe luan në pozitën alo. Ishte ndër lojtarët më të dalluar në St. John's University në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kishte një mesatare prej 11.7 pikëve, 4.5 kërcimeve, 1.21 asistimeve. Shquhet për lojën në mbrojtje dhe ngulitjet atraktive", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Zeneli refuzon Fenerbahçen

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, e ka refuzuar ofertën e skuadrës së Fenerbahçes. Arsye e refuzimit është fakti se Zeneli dëshiron të luajë në një ligë më të fortë se ajo e Turqisë. "Tifozët e Fenerbahçes më kanë shkruar në shumë vende, i respektoj si tifozë dhe si klub, por unë dua të luaj në liga më të mëdha në Evropë. Nuk e di çfarë do të ndodhë, por qëllimi im është të luaj në Angli, Spanjë, Gjermani dhe Itali", ka thënë Zeneli.

Eminhaziri prezantohet te KEK-u

Isa Eminhaziri është bërë me skuadër të re pas largimit nga Drenica. Sulmuesi në fjalë e ka zgjedhur KEK-un si ekipin ku do ta vazhdojë karrierën. Eminhaziri është prezantuar në ambientet e KEK-it, kurse në të kaluarën ishte pjesë e Gjilanit dhe Feronikelit.

Juniku përforcon Rahovecin

KB Rahoveci ka arritur marrëveshje për transferimin e basketbollistit Fisnik Juniku. 28-vjeçari ka përvojë të gjatë në basketbollin vendor, ndërsa së fundmi ishte pjesë e Lipjanit, duke luajtur rol kyç në futjen e kësaj skuadre në Superligë. Juniku është veçuar edhe në pjesën e parë të kampionatit në Superligë duke u bërë edhe koshashënuesi më i mirë i Lipjanit.

Challandesi për mediet çeke: Kosova synon kualifikimin në "Euro 2020"

PRISHTINË, 4 JANAR - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, për mediet çeke ka thënë se Kosova synon të kualifikohet në "Euro 2020" nga grupi me Anglinë, Çekinë, Malin e Zi dhe

Bullgarinë. "Ky grup nuk është i lehtë për ne, por jo edhe i pamundur, ndonëse Anglia është favorite absolute", ka thënë Challandes për "idnes.cz". "Kualifikimi kërkohet nga e para. Kështu që ne do

ta kërkojmë kualifikimin nga kampanja eliminatorë për 'Euro 2020'. Por, nëse gjërat shkojnë keq në këto kualifikime, atëherë do ta kemi shansin tjetër përmes Ligës së Kombeve. Nuk kuptoj pse

Kosova të mos e ketë një ëndërr të mirë kur ne mund ta ndjekim atë", ka deklaruar Challandes. Trajneri zviceran foli edhe për tifozët e zjarrtë që po e mbushin stadiumin "Fadil

Vokri", duke thënë se: "E shoh stadiumin tonë të rinovuar në Prishtinë, ku kundërshtarët po kenë shumë problem. Ndërsa ne vazhdimisht po e shfrytëzojmë shansin në stadiumin tonë".

Ronaldo: Dua të shënoj shumë gola dhe të fitoj gjithçka me Juven

DUBAI, 4 JANAR - Cristiano Ronaldo nuk fitoi "Topin e Artë", por 2019-n e ka nisur me një trofe. Portugezi i Juventusit e fitoi çmimin e "Globe Soccer Awards" për 2018-n, event i cili u organizua në Dubai. Gjithashtu, u vlerësua edhe për golin më të

bukur për vitin që lamë pas, pikërisht atë të realizuar gjatë kohës kur luante me Realin ndaj Juventusit. "Ishte një vit i vështirë për mua, ku fitova edhe shumë trofe. Dua t'i falënderoj të gjithë ata persona që menduan se unë e meritoja këtë trofe.

Është nder i madh për mua", ka thënë Ronaldo, duke shtuar: "Kam shënuar 700 gola në karrierën time dhe dua të shënoj akoma edhe më shumë. Për sa iu përket objektivave, mund të them se luaj në një skuadër kampionësh dhe të gjithë dëshiroj

ta arrijnë maksimumin në çdo kompeticion ku garojnë. Kjo është edhe dëshira ime. Të vazhdoj të shënoj gola edhe pse të gjithë e dimë sa e vështirë është, por unë të jap gjithmonë më të mirën siç edhe kam bërë ndër vite".



Klubi gjerman: Mavraj, luftëtar i jashtëzakonshëm

INGOLSTADT, 4 JANAR - Mërgim Mavraj tashmë mund të quhet zyrtarisht një lojtar i FC Ingolstadt 04 në Bundesligën e dytë gjermane. Pas një aventure në gjysmën e parë të sezonit tek Arisi në Greqi, mbrojtësi vendosi të largohet dhe të rikthehet në Gjermani. Kapiteni i Kombëtares shqiptare ka firmosur një kontratë deri në vitin 2020 dhe do të udhëtojë menjëherë drejt Alikantes në Spanjë për fazën përgatitore të ekipit. Mavraj konsiderohet një përforcim i nevojshëm për mbijetesën. "Mërgimi sjell te ne cilësitë që na duhen për të qëndruar në ligë dhe ta arrijmë objektivin sezonal. Ai është një fitues i vërtetë, e njeh futbollin gjerman dhe është luftëtar i jashtëzakonshëm", ka thënë Harald Gartner, drejtor për komunikim në klub. Ndërkohë, vetë Mavraj e pranon këtë sfidë të re në karrierë: "Jam i bindur që do luftojmë për të dalë nga kjo situatë e vështirë. Në karrierën



time kam përjetuar çaste të ngjashme dhe tani dua ta sjell përvojën time në klub". Ingolstadt gjendet në vendin e fundit, atë të 18 në Bundesligën e

dytë gjermane, me 10 pikë, ndërsa lufton për të mos rënë nga kategoria dhe para vetes ka tri ekipe të tjera, me një diferencë prej vetëm tri pikësh.

Houstoni befasoi Golden Staten, Hardeni shkëlqen me 44 pikë



OAKLAND, 4 DHJETOR - Golden State Warriors dhe Toronto Raptors janë thyer. Kampionët në fuqi e kanë pësuar përballë të magjishmit James Harden, i cili po kalon një formë të shkëlqyer dhe nuk e ka ndalur serinë e të shënuarit më shumë se 40 pikë. Këtë herë ka realizuar 44, ndërkohë që ka regjistruar triple-double me 15 asistime dhe 10 topat e rikuperuar. Në formë është edhe Clint Capela, me 29 pikë e 21 topa të rikuperuar. Curry shënoi 35 pikë, kurse

Duranti e Thompsoni nga 26 pikë për kampionët në fuqi. Warriors, në fakt, e nisi mirë, pasi në dy periodat e para arriti ta sigurojë një epësi prej 17 pikësh. Rocketsi u zgjua dhe arriti ta barazojë dhe ta çojë ndeshjen në shtesë, duke triumfuar 134-135. Toronto Raptorsi nuk i ka bërë dot ballë "furisë" së San Antonio Spursit pasi u mund 125-107. DeMar DeRozan ishte lideri i skuadrës nga Teksasi. "Triple-double" për të: 21 pikë, 11 asistime, 14 topa të rikuperuar.

Por Spursat ishin lart në tërësi, pasi LaMarcus Aldridge (23 pikë), Bryn Forbes (20 pikë) dhe Derrick White (19 pikë) realizuan një numër të konsiderueshëm pikësh. Vijon të fitojë edhe Denver Nuggets, që ka kaluar me sukses Sacramento Kingsin me rezultatin 113-117. Jamal Murray ishte lideri i skuadrës, me 36 pikë të realizuara. Paraqitje shumë të mirë pati edhe Nikola Jokiq që realizoi 26 pikë, 6 asistime dhe rikuperoi 13 topa.

SHKURT

Rangersi transferon 36-vjeçarit Defoe

Sulmuesi veteran Jermain Defoe është larguar nga skuadra e Bournemouthit për t'u bashkuar me Rangersin e Eros Grezdes dhe Stiven Gerrardit. Skuadra skoceze me transferimin e 36-vjeçarit synon ta rivalizojë fuqishëm Celticun në garë për titull të kampionit. Deoe në të kaluarën ka luajtur edhe për Tottenham Hotspurin, West Ham Unitedin, Portsmouthin dhe Sunderlandin.

City rrezikon të dënohet nga UEFA

Manchester City mund të përjashtohet nga edicionet e ardhshme në kupat e Evropës. Lajmi që qarkullon prej javësh është konfirmuar sërish, këtë radhë nga Yves Leterme, kryetar i komisionit të kontrollit financiar në UEFA. Sipas Leterme, i cili ka folur për një të përditshme në Belgjikë, Manchester City do të dënohet nëse zbulimet e Football Leaks do të konfirmohen. Bëhet fjalë për 60 milionë sterlina që grupi që zotëron Cityn, Abu Dhabi United Group, i ka derdhur në arkat e klubit, duke deklaruar si sponsorizim nga "Etihad". "Nëse gjithçka që është shkruar është e vërtetë, mund të kemi një problem serioz përpara. Kjo mund të çojë në dënimin më të rëndë të mundshëm: përjashtim nga kupat e Evropës. Klubi anglez ka deklaruar gjëra që rezultojnë jo të vërteta, sipas Football Leaks, ndaj tani do të verifikojmë gjithçka", ka thënë Leterme.

Murieli zgjodhi Fiorentinën para Milanit

Luis Muriel e ka refuzuar Milanin dhe iu ka bashkuar skuadrës së Fiorentinës. Sulmuesi i Sevillas është huazuar te skuadra italiane në gjashtë muajt e ardhshëm. "Zgjedha Fiorentinën për historinë që ky klub ka dhe përfaqëson. Kisha folur me Corvinon dhe i kisha dhënë fjalën, ndaj nuk mund të mos vija në Firence", ka thënë Muriel.

Gabigoli kërkon një rast nga Interi

Gabriel Barbosa, i njohur si Gabigol, dëshiron një rast nga Interi, ani pse për shërbimet e tij janë të interesuar West Ham United dhe Flamengo. Sulmuesi, i njohur si Gabigol, u dërgua në huazim te ish-klubi, Santos, pasi nuk arriti të bëjë asnjë ndeshje si titullar në Serinë A për 'Nerazzurët' pas lëvizjes së tij në 2016-n. "Para çdo vendimi unë dua të flas me Spallettin. Unë do të jem në Itali më 7 janar për një takim. Dua të më jepet një shans tek Interi", ka deklaruar Gabigol.

Kloppi: Ishim të pafat, Kompany duhej të ndëshkohej

Jurgen Klopp ka thënë se ekipi i tij ishte i pafat në humbjen prej 2-1 ndaj Manchester Cityt, derisa ka theksuar se Vincent Kompany do të duhej të ndëshkohej me karton të kuq si lojtari i fundit që ishte pas ndërhyrjes në Salahun. "Ishte presion i madh. Një ndeshje shumë intensive. Ishim të pafat në çastet e finalizimit, më pa fat sesa City. Nuk ishte ndeshja më e mirë e jona ose e Cityt për shkak se ia vështirësua punët njëri-tjetrit", ka thënë Klopp. "Vërtet më pëlqen Vincent Kompany, por s'e kuptoj se si nuk u ndëshkua me të kuq. Ai është lojtari i fundit që ndërhy. Nëse ai e godet aq shumë Salahun mund ta humbë sezonin. Nuk është e lehtë për gjyqtarin dhe ndoshta ai nuk e sheh ashtu siç e shoh unë. Me më pak fat do të merrnin barazimin 2-2, që do të ishte perfekt për ne", ka deklaruar Klopp.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT DHE E SHKENCËS NË PRIZREN

Nr.12/2019
Datë: 04.01.2019

Në bazë të nenit 35 të ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, nenit 8 i ligjit të Punes nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.17/2009 (MASHT) – procedura e zgjedhjes personalit arsimore në shkollë, Udhëzimi Administrativ nr 10/2018(MASHT) – Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, udhëzimi administrativ nr 05/2015 (MASHT) – normativi për arsimin profesional dhe udhëzimi administrativ nr 07/2017 (MPMS) – rregullimi i procedurave në sektorin publik, Drejtoria Komunale për Arsim shpall:

KONKURS

Për vende të lira pune

1. Një mësimdhënës për Lëndën Gjeografi dhe Edukatë Qytetare, në SHFMU “Pjetër Mazreku” në Mazrek, 18 orë në javë (31.08.2019)
2. Një mësimdhënës për Lëndën Edukatë Fizike në SHFMU “Haziz Tola” në Prizren, 20 orë në javë (31.08.2019)
3. Një mësimdhënës për Lëndën Edukatë Muzikore në SHFMU “Haziz Tola” në Prizren, 20 orë në javë
4. Një mësimdhënës për Lëndën Gjuhë Angleze SHFMU “Haziz Tola” në Prizren, 20 orë në javë (31.08.2019)
5. Një mësimdhënës për Lëndën Gjuhë Angleze në SHFMU “Pjetër Budi” në Lugisht të Hasit, 20 orë në javë (31.08.2019)
6. Një mësimdhënës për Lëndën Edukatë Muzikore në SHFMU “Dëshmorët e Kabashit” në Korishë, 10 orë në javë
7. Një mësimdhënës për Lëndën TIK –ut në SHFMU “Pjetër Mazreku” në Mazrek, 13 orë në javë

Kushtet:

- Për të gjitha vendet e punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 10/2018 - normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 05/2015 - normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional,
- Kopjen e vërtetuar të diplomës
- Nostifikimin, nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës.
- Dëshminë mbi përvojën e punës.
- Trajnimet profesionale.
- Certifikatën e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore, kandidati e sjell pasi të pranohet në punë.
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.
- Aplikacionet merren në DKA dhe dorëzohen të plotësuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar në DKA.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë deri më datë **18.01.2019**.
- Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk i kthehet kandidatëve.

Drejtori
Skender Susuri



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr. 02/3
Dt. 04.01.2018

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2018/19 KLASËT E 10-ta
PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL –MESIMI PËR TE
RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë Teknike „ 11 MARSI ” në Prizren, shpallim këto profile mësimore:

I. MAKINERI

- | | |
|--|---------------|
| 1. Metalpunues | 1 PAR.- 24nx. |
| 2. Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit | 1 PAR.- 24nx. |
| 3. Instalues i Ujësjetës dhe Kanalizimit | 1 PAR.-24nx. |
| 4. Automekanik | 1 PAR. 24nx. |

II. ELEKTROTEKNIKË

- | | |
|-----------------------|---------------|
| 1. Instalues elektrik | 1 PAR.- 24nx. |
| 2. TIT | 1 PAR.- 24nx. |
| 3. Informatikë | 1 PAR.- 24nx. |

III. NDERTIMTARI

- | | |
|----------------|---------------|
| 1. Arkitekturë | 1 PAR.- 24nx. |
|----------------|---------------|

IV. Arte të aplikuara

- | | |
|---------------------|---------------|
| 1. Dizajn i veshjes | 1 PAR.- 24nx. |
|---------------------|---------------|

V. Komunikacion

- | | |
|------------------|---------------|
| 1. Trafik rrugor | 1 PAR.- 24nx. |
|------------------|---------------|

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimit për të rritur në shkollë profesionale, për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve , bëhet 7ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës SHMLT „ 11 MARSI “ në Prizren, nga ora 8.00-16.00. Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse 3(tri) ditë pas mbylljes së konkursit.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:01/3
Dt: 04.01.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Sh.M.L.T "11 Marsi" në Prizren dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2018/2019

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
ShMLT	"11 Marsi"	Prizren	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Bazat e Elektroteknikës me 12 orë në javë	Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) instruktor për profilin Teknik Dentar 20 orë	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon nëmënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Fakulteti i Elektroteknikës, diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lartë;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlihdje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen dhe;
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe vizionit në krijimin dhe drejtimin e QK-së si një institucion që garanton cilësi të lartë, të cilat duhet të jenë parakushte themelore.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në ShMLT, 11 Marsi në Prizren dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

GJASHTË DITË PA TY



FEHMI DAUT KRYEZIU

(6. 9. 1981 - 31. 12. 2018)

I dashur bir, vëlla, bashkëshort, baba, xhaxha, nip, kunat, e kemi shumë të vështirë të shkruajmë shumë fjalë përkujtimore për ty sepse dhembja që ndiejmë për ty na ka shtangur të gjithëve në vend. Megjithatë, kemi këtë fjali në majë të gjuhës: Dritë të bëftë shpirti!
E përkujtojnë: familja Kryeziu nga Bubaveci i Malishevës dhe familja Bashota nga Caraviku i Klinës.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-111 dhe në harmoni me Ligjin për Kontabilitet, Raportimin Financiar dhe Auditimit Ligji nr06/L-032 Kodit të Etikes dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI" SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.11.2018, dhe vazhdimin e mbledhjes me 29.11.2018 vendosi që me datë 04.01.2019 të shpall ketë:

VAZHDIM I KONKURSIT

Pozita: Zyrtar për Auditim të Brendshëm
KRM "UNITETI" Sh.a
I përgjigjet: Komitetit të Auditimit-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Ekonomik-Financa kontabilitet
- Të dëshirushëm SCAAK IKAF ose shoqatat tjera profesionale,
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në auditim.
- Të jetë i certifikuar.
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë njohuri të shkëlqyera të Financave Publike, aftësi të dëshmuara në proceset e auditimit .
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të jetë njohës i mirë i gjuhëve zyrtare
- Të mos jetë i denuar ose nën hetime
- Të shkathësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komitetit për Auditim dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari për Auditim të Brendshëm do të jetë përgjegjës që të :
- Të udhëheqë, menaxhojë dhe organizojë zyrën për auditim të brendshëm Të udhëheqë dhe drejtojë të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Të gjitha detyrat tjera të përcaktuara nga Komiteti i Auditimit.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitë e Sekretarës të KRM. "UNITETI" SH.A. Mitrovicë.

Konkursi zgjatë 7 ditë, dorëzimi i dokumentave fillon nga data 08.01.2019, dhe përfundon në ora 16.00 të datës 14.01.2019.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 i ndryshuar dhe i plotsuar me Ligjin 04/L-111 harmoni me Kodit të Etikes dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI" SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.11.2018 dhe vazhdimin e mbledhjes me: 29.11.2018, vendosi që me datë 04.01.2019 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Sekretar-e i KRM "UNITETI" Sh.a
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Juridik,
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të jetë njohës i mirë i gjuhëve zyrtare
- Vërtetimin nga Gjykata që nuk është nën hetime
- Të jetë komunikativ dhe të ketë aftësi organizative dhe menaxherial

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Do të mbajë regjistrin e akcionarëve .
- Veproj si agent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve.
- Të bëjë të gjitha arkivimet e nevojshme, publikimet dhe njoftimet me autoritet e duhura që kërkohet me ligj dhe me akte nënligjore.
- Të mbikqyrë mirmbajtjen e duhur dhe azhurimin e rregullt të ueb faqes të parashikuar me seksionin VIII(6)
- Të koordinojë me KSHE-në pregaditjen e shkresave për mbledhjet të Bordit të Drejtorëve.
- Sekretari do të mbajë procesverbalin për secilën Mbledhje të Përgjithshme dhe Mbledhjet të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit për Auditim (Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) si dhe do të shenojë ato në librin e procesverbaleve. Procesverbali duhet të përmbajë informatat në vijim: emrat. e të pranishëmve, vendin dhe datën mbledhjes, çështjet kryesore që ngrihen gjatë diskutimit të pikave individuale të rendit të ditës, tekstin e vendimit të propozuar rezultatin e votimit dhe votat e dhëna nga secili individ, tekstin e saktë të vendimeve të miratuara si dhe çfarëdo kundërshtimi të bërë lidhur me ato vendime.
- Procesverbali i mbledhjes së kuvendit të nënshkruar nga kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretari dhe dorzohet për tu miratu në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit
- Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve duhet të dorzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të Bordit të Drejtorëve dhe duhet të nëshkruhet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Sekretarit.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Programi zhvillimor për kompaninë

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitë e Sekretarës të KRM. "UNITETI" SH.A. Mitrovicë.

Konkursi zgjatë 7 ditë, dorëzimi i dokumentave fillon nga data 08.01.2019, dhe përfundon në ora 16.00 të datës 15.01.2019

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

Tri vite pa ty e dashura jonë



Mihrije (Thaçi) Morina

Me humbjen tënde zemrat tona u goditën rënd. Jemi krenar që të patëm të tillë. Gjithmonë do të jesh në kujtesën tone. Do të jetojmë me dhembje që të humbëm por krenar që të patëm.

Të përkujtojnë djemtë: Rexhepi, Haxhija dhe Ramizi vajzat Hysretja, Ryvija, Hatixhja e Myrvetja e ne veçanti djali Ramizinipi Shqiptari mbesa Erblina.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Besnik Qunaj shpall te pavlefshme certifikatën e IAPP "Dituria" Furrar 2018, Prizren.
- ▶ Lirije Shala shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.
- ▶ Liridone Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren
- ▶ Lumnije Balaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren.
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- liti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrerës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

